PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.505, DATË 24.10.1994 “PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË KUADROVE USHTARAKË AKTIVË, QË SHËRBEJNË NË STRUKTURAT E USHTRISË”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998 “Për buxhetin e shtetit të vitit 1999”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.505, datë 24.10.1994 “Për trajtimin me ushqim të kuadrove ushtarakë, aktivë, që shërbejnë në strukturat e ushtrisë”, pika 3 ndryshohet si vijon “:

“3. Trajtimi sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të bëhet vetëm për ditët efektive të punës së çdo ushtaraku, si dhe për ditët e shtuna, të diela, festa zyrtare, për ushtarakët, që vazhdojnë studimet në Akademinë e Mbrojtjes, apo që ndjekin kurse të tjera kualifikimi e që nuk kanë mundësi të shkojnë pranë familjes në këto ditë, dhe, në çdo rast, vetëm për kuadrot ushtarakë, efektivë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes.”

2. Efekti ekonomik të përballohet nga buxheti vjetor, i miratuar për vitin 1999 për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 155, datë 1.4.1999

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE LAJMËRIMIT TË POPULLATËS NË RAST KUSHTRIMI AJROR

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Institucionet qendrore, prefekturat, bashkitë, këshillat e rretheve dhe komunat, të vendosin mjetet dhe sinjalet e kushtrimit ajror.

2. Me dhënien e urdhërit për kushtrimin ajror nga Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë të detyruar për ta transmetuar:

Radio-Televizioni shqiptar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Postave të Shqipërisë kur ai është për të gjithë territorin e vendit.

Media elektronike lokale kur ai është i pjesshëm.

3. Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Informacionit dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrin aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

4. Shpenzimet për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga fondet e miratuara për këto institucione, për vitin 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.166, datë 7.4.1999

PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË FORCAVE USHTARAKE TË NATO-S SË HAPËSIRËS AEROPORTUALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr.8470, datë 7.4.1999 “ Për pranimin në Shqipëri të një force të NATO-s, në mbështetje të operacioneve ushtarake në rajon”, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Vënien në dispozicion të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) të hapësirës ajrore e detare, si dhe aeroportet e portet detare të Republikës së Shqipërisë, për t’u përdorur nga avionët, helikopterët, anijet dhe pajisjet e tjera ushtarake të kësaj organizate.

2. Krijimin e lehtësive të nevojshme për përdorimin dhe kontrollin e hapësirës ajrore e

detare të Republikës së Shqipërisë nga forcat ushtarake të NATO-s.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Rendit Publik për realizimin, koordinimin dhe bashkëpunimin me forcat ushtarake të NATO-s, në zbatim të këtij vendimi.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.616, datë 10.10.1998, dhe nr 827, datë 30.12.1998 “ Për krijimin e lehtësirave të veprimtarisë së avionëve dhe të anijeve ushtarake të Organizatës të Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) në Republikën e Shqipërisë” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

NR.170, datë 8.4.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.307,
DATË 19.5.1998 “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NR.182, DATË 25.4.1995 “PËR ÇMIMET E SHITJES SË BARNAVE”,
NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.21, DATË
31.1.1997**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 414, të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.307, datë 19.5.1998 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.182, datë 25.4.1995, në pikën 1, pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me shumicë të barnave nga Fufarma, Sh.a. Tiranë, institucionet shëndetësore, shtetërore, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, caktohet deri në 7 për qind mbi çmimin fillestar të blerjes CIF, konvertuar në lekë sipas kursit përkatës, mesatar që njoftohet nga Banka e Shqipërisë për çdo 6-mujor”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet deri më datën 30.6.1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 183, datë 15.4.1999

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.723, DATË 19.11.1998 “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN E INVALIDIT””

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “ Për statusin e invalidit”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Në pikën 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.723, datë 19.11.1998 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përfitojnë rimbursimin e shpenzimeve, për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikantëve, edhe ata invalidë, që nuk përcaktohen si të tillë në nenin 1,të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “ Për statusin e invalidit”, por që për arsye riaftësimi janë pajisur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore me mjete motorike, para vitit 1994.”

2.Efektet financiare nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1.1.1999 dhe përballohen nga buxheti i vitit 1999 për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 188, datë 15.4.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.113, DATË 26.2.1993 “PËR PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS PËR PLOTËSIMIN E KËRKESAVE TË PËRFAQËSIVE TË HUAJA”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.113, datë 26.2.1993, pika 6 ndryshohet si vijon:
“Drejtoria e shërbimit të trupit diplomatik, për kryerjen e funksioneve, shfrytëzon burimet e veta financiare nga shërbimet ndaj të huajve dhe burimet financiare nga qiratë, për të realizuar mirëmbajtjen, meremetimin, ndërtimet e reja apo blerjen, brenda e jashtë vendit, të mjediseve të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë diplomatike dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës së trupit diplomatik, shqiptar apo të huaj. Gjithashtu, me burimet

financiare të përmendura më sipër drejtoria e shërbimit të trupit diplomatik përballon, tërësisht apo pjesërisht, qiratë e përfaqësive tona jashtë shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.192, datë15.4.1999

PËR SHPRONËSIMIN DHE KOMPENSIMIN E TOKËS BUJQËSORE TË TETË FAMILJEVE TË FSHATIT BRURËZ, TË CILAT PËRMBYTEN NG UJËMBLEDHËSI I BOVILLËS

Në mbështetje të neneve 4 e 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994 ”Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prej 53 798 m² tokë bujqësore, që përmbyten nga ujëmbledhësi i Bovillës, e që ndodhen në territorin e fshatit Brurëz, sipas listës emërore, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të cilët shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas listës emërore dhe sipas masës së kompensimit, të cilat paraqiten në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për shumën e përgjithëshme 25 285 060 (njëzetepesë milionë e dyqindetëdhjetepesë mijë e gjashtëdhjetë) lekë.
 4. Fondi për kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të përballohet nga fondi i miratuar për këtë objekt, në buxhetin e shtetit të vitit 1999 për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.
 5. Shpronësimi të përfundon brenda datës 31 dhjetor 1999.
 6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Komuna Cudhi, e rrethit të Krujës, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LISTA EMËRORE E KRYEFAMILJARËVE TË FSHATIT BRURËZ QË DO TË
SHPRONËSOHEN DHE TË KOMPENSOHEN SIPAS V.K.M. NR.297 DATË 15.05.1998

Nr.	Emri Mbiemri	Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas tapive në m2	Çmimi në lekë	Vlera në lekë
1.	Ali Afmet Mullahi	4728	470	2222160
2.	Bajram Afmet Mullahi	6800	“	3196000
3.	Isuf Tahir Afmeti	4482	“	2106540
4.	Besim Tahir Afmeti	7528	“	3538160
5.	Asllan Tahir Afmeti	11053	“	5194910
6.	Hasan Xhemal Llani	5583	“	2624010
7.	Xhemal Asllan Llani	8718	“	4097460
8.	Mehmet Selman Afmeti	4906	“	2305820
	Shuma	53798	-	25285060

V E N D I M

Nr. 193, datë 22.4.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKM NR.38, DATË 31.1.1994 “PËR TRAJTIMIN E
NDIHMAVE HUMANITARE FALAS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.38, datë 31.1.1994 bëhen këto ndryshime:

1.Pika 2, ndryshohet si vijon:

“Komisioni përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Pushtetit Lokal, Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Ministrisë së Shëndetësisë.

Përbërja e Komisionit miratohet nga Kryeministri mbi bazën e propozimeve të titullarëve të ministrive përkatëse”

2.Pika 11, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.194, datë 22.4.1999

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr.7583, datë 13.7.1992 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për punonjësit mësimorë, në arsimin parashkollor, arsimin 8-vjeçar, arsimin e mesëm, bazat prodhuese në shkollat teknike profesionale, konviktet e këtyre shkollave dhe në qendrat kulturore të fëmijëve, skema e strukturës së pagës është sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Struktura e pagës mujore përbëhet:

I. Pagat e grupit, sipas nivelit arsimor, të kërkuar nga vendi i punës:

- | | | |
|---------------------|-----|------------------------------|
| - Paga e grupit I | “1” | Diplomë e shkollës së lartë |
| - Paga e grupit II | “2” | Diplomë mbi shkollën e mesme |
| - Paga e grupit III | “3” | Diplomë e shkollës së mesme |
| - Paga e grupit IV | “4” | Dëftesë lirimi. |

Diploma mbi shkollën e mesme janë të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në legjislacionin në fuqi. Në këtë grup përfshihen, gjithashtu, të gjithë ata, të cilët kanë mbaruar 2 vite akademike të shkollës së lartë.

Pagat për çdo grup pune janë sipas lidhjes nr.2, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Shtesa për vjetërsi pune, në profil, jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

III. Shtesë kualifikimi. Kjo shtesë jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit, në përqindje, si vijon:

- Në masën 5 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së tretë;
- Në masën 10 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së dytë;
- Në masën 20 për qind, për ata me dëshmi kualifikimi të shkallës së parë.

IV. Shtesa e pozicionit është e përcaktuar për çdo vend pune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Mësuesit, që punojnë larg vendbanimit, marrin një shpërblim mujor sipas lidhjes nr.3, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Punonjësit e jashtëm, inxhinierë, agronomë, ekonomistë, etj., që japin mësim në shkollat e mesme dhe në shkollat teknike e profesionale, për çdo orë mësimi paguhet me 145 (njëqindëdyzetepesë) lekë.

Punonjësit mësimorë, që për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën mësimore, të lejuar me dispozita, paguhet për çdo orë mësimore si vijon:

- në shkollat e mesme.....145 (njëqindëdyzetepesë) lekë;
- në shkollat 8-vjeçare.....120 (njëqindënjëzet) lekë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Pushtetit Lokal, në

bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

6. Efektet ekonomike, për zbatimin e këtij vendimi, janë parashikuar në buxhetin e vitit 1999.

7. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992, “Për pagat e punonjësve në institucionet buxhetore”, bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 7, pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Punonjësit, që i kanë përfituar këto shtesa, do të vazhdojnë t’i përfitojnë ato, derisa të qëndrojnë në këtë vend pune. Punonjësit, që fillojnë punë për herë të parë në arsim, nuk i përfitojnë ato.

Për raste të veçanta, Këshilli i Ministrave miraton shtesa, të cilat nuk përfshihen në pagë.”.

- Pika 10 nuk zbatohet për mësuesit.

8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.136, datë 25.3.1994, “Për shtesën në pagë për vështirësi shërbimi të punonjësve, që punojnë drejtpërdrejtë me fëmijët dhe nxënësit, në sistemin e arsimit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 maj 1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
	PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E PROFESIONIT	
	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për Pozicion (SHP)	Totali
Drejtor shkollës së mesme Përgjegjës poligoni Dr.Inst.të Nxën.që nuk shikojnë Drejt.Inst.të nxën. që nuk dëgjojnë Dr. në Shkollat me PLM Drejtor i Konvikteve	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	9339 lekë	Nga...lekë Deri ... lekë
Zv/Dr. në shkollë të mesme Dr.i Shkollës 8-vjeçare Zv/Dr. në inst.e nx.që nuk shikojnë e dëgjojnë dhe shkollat me PLM. Dr.i Qendr.Kult.të Fëmijëve Përgjegjës i bazës prodhuese	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	8200 lekë	Nga ... lekë Deri ... lekë
Dr. i shkollës fillore (klasa e I-IV) Përgj.(kryemësues) i shk. me klasë kolektive Zv/Dr. i shk. 8-vjeçare Përgj.sekt në Qend.Kult.Fem.	1	“	“	7 125 lekë	Nga ...lekë Deri ... lekë

Dr. i Kopshtit me Ushqim	1	“	“	6228 lekë	“
Dr. i Kopshtit pa Ushqim	1	“	“	5184 lekë	“
Mësues në shkollat e mesme Mësues në Shk. së Ulët Profesionale Mësues në Inst. E Nx. që nuk shikojnë e dëgjojnë dhe Shk. me PLM.	1	“	“	6558 lekë	Nga ... lekë Deri ... lekë
Mësues në Shk.8-vjeçare (I- VIII) Edukatore Konvikti. Kujdestar Konvikti. Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	“	“	5720 lekë	Nga ... lekë Deri ...lekë
Edukatore në Kop.Fëmijësh.	1	“	“	4720 lekë	“
Mësues në shk.të mes. dhe 8- vjeçare	3	“	“	5720 lekë	
Edukator në kop. fëmijësh.	3	“	“	4720 lekë	“

LIDHJA NR.2

Grupi	Paga në lekë
1.	6 000 lekë
2.	5 000 lekë
3.	4 500 lekë
4.	3 000 lekë

LIDHJA NR.3

SHPËRBLIMI MUJOR PËR PUNONJËSIT MËSIMORE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR QË PUNOJNË LARG VENDBANIMIT

Mësuesit që punojnë larg vendbanimit të tyre marrin shpërblim, si vijon:

- Kur punojnë brenda rrethit të tyre por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 970 lekë, kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 2910 lekë
- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre, në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë, deri në 3 880 lekë kur punojnë në qytetet dhe në qendër të rrethit, dhe deri në 4 850 lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.
- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd, deri në 2910 lekë kur punojnë në qytet dhe në qendër, dhe deri 3 880 lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.
- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet e tjera deri në 1940 lekë, kur punojnë në qytete dhe në qendrën e rrethit, dhe deri 2910 lekë kur punojnë jashtë qytetit e qendrës së rrethit.

V E N D I M

Nr.199, datë 22.4.1999

PËR RRIJTJEN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagat rriten mesatarisht 10 për qind. Nuk përfshihen në këtë rritje punonjësit mësimor të sistemit parauniversitar.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.12.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja I “Pagat mujore të titullarëve të organeve të larta shtetërore, institucioneve të tjera qendrore dhe pagat e personave të barazvlefshëm me ta” dhe lidhja nr.2 “Klasifikimi i pagave të punonjësve të administratës së lartë shtetërore, institucioneve qendrore dhe funksionarëve të pushtetit lokal”, zëvendësohen me lidhjet, që i bashkëlidhen këtij vendimi, kurse në lidhjet përkatëse të niveleve të pagave mujore sipas funksioneve të tjera në Presidencë, Kuvend, Këshilli i Ministrave, ministri dhe institucione të tjera qendrore bëhen ndryshimet, sipas tabelave, me të njëjtin numër, që i bashkëngjiten këtij vendimi.

b) Lidhja II “Paga bazë sipas klasave” dhe lidhja II/M “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, RTV, ATSH dhe prefekturave”, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

c) Pika 11 ndryshohet si vijon: “Punonjësve të jashtëm, që japin mësim në shkollat e larta, për çdo orë mësimi u jepet 260 lekë”.

d) Pika 12 ndryshohet si vijon: “Punonjësve të jashtëm, inxhinier, ekonomist, agronom, etj, që japin mësim në shkollat e mesme, në shkollat e ulta profesionale dhe në kurset e ndryshme (me përjashtim të kurseve që ngrihen pranë shkollave të larta, Institutit Pedagogjik dhe drejtorisë së kualifikimit të kuadrit të arsimit), për çdo orë mësimore u jepet 145 lekë”.

e) Pika 16 ndryshohet si vijon: “Punonjësit mësimorë, që për nevoja të procesit mësimor japin orë mësimi mbi normën mësimore vjetore (të lejuar me dispozitë) paguhet për çdo orë mësimore në shkollat e larta 260 lekë, në shkollat e mesme 145 lekë dhe në shkollat 8-vjeçare 120 lekë.

f) Në pikën 17, paga bazë mujore për emërtimet:

- | | |
|---|-------------|
| - Profesor, drejtues kërkimesh bëhet | 34 100 lekë |
| - Asistent profesor, mjeshtër kërkimesh bëhet | 28 600 lekë |

Për punonjësit që nuk janë efektivë në shkollat e larta ose në institutet kërkimore shkencore, po janë bashkëpunëtorë në veprimtaritë e tyre, si dhe punonjësit efektivë të shkollave të larta, që nuk janë punonjës pedagogjikë (janë nëpunës) u jepet shpërblim sipas emërtesave që vijojnë:

- | | |
|--|------------|
| - Profesor, drejtues kërkimesh | 4 400 lekë |
| - Asistent profesor, mjeshtër kërkimesh | 3 850 lekë |
| - Për gradën shkencore, doktor i shkencave | 3 300 lekë |

g) Në lidhjen II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore” bëhen këto ndryshime:

- Në numrin rendor 6 shtohet emërtimi “Drejtor drejtorie në ministri” dhe shfuqizohet ky emërtim në numrin rendor 7.

- Në fund të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Emërtime të tjera për Ministrinë e Drejtësisë”

- | | |
|--|----|
| - Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve | B1 |
| - Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Burgjeve | B3 |

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.328, datë 26.6.1995 “Për trajtimin ekonomiko-

financiar të efektivit të njësisë së transportit mjekësor me helikopter”, në pikën 1, pagat bëhen si vijon:

“- Përgjegjësi i njësisë së transportit mjekësor me helikopter	16 000 lekë
- Pilot helikopteri	12 800 lekë
- Teknik helikopteri	11 220 lekë
- Mjek	11 220 lekë
- Infermier i ndihmës së shpejtë të njësisë së helikopterit	7920 lekë

4. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.406, datë 19.6.1995 “Për forcimin e rrjetit hidrometereologjik dhe sizmologjik”, në pikën 2, paga për vrojtuesit bëhet 2 200-2750 lekë në muaj.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga fondet e miratuara nga buxheti i shtetit për vitin 1999.

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.694, datë 21.10.1996 “Për normën mësimore e shkencore në shkollat e larta dhe në arsimin pasuniversitar, pagimin e orëve suplementare, aktivizimin e pensionistëve dhe punonjësve të jashtëm në sistemin arsimor” shfuqizohet.

7. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 1.5.1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lidhja nr.1

RENDITJA E FUNKSIONEVE TË KLASIFIKIMIT

A1 Presidenti	132 200
A2 Kryeministër. Kryetar i Kuvendit	121
100	
A3 Zëvendëskryeministër. Zëvendëskryetar i Kuvendit.	93
850	
A4	
A5 Ministër	82 500
A6 Sekretar Shteti	77 000
A7 Sekretar i Përgjithshëm në Presindencë. Sekretar i Përgjithshëm në	
71 500	
Këshillin e Ministrave. Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit.	
Kancelar i Gjykatës së Lartë.	
A8 Deputet	66 000
A9 Kryetar i Akademisë së Shkencave	60
550	
Prefekt i Tiranës	
Kryetar i Bashkisë së Tiranës.	
A10 Shef Kabineti në Presindencë. Drejtor Kabineti në Këshillin e Ministrave.	
58 500	
Shef Kabineti në Kuvend.	
A11 Këshilltar i Presidentit. Këshilltar i Kryeministrit.	57
200	
Këshilltar i Kryetarit të Kuvendit.	
Zëdhënës i Presidentit, zëdhënës i Kryeministrit.	
Zëdhënës i Kryetarit të Kuvendit.	

A12 Zëvendësministër. 56 100 Kryetar i Komitetit Shtetëror për Kontrollin e Figurave të zyrtarëve. Prefekt. Drejtor i Përgjithshëm i RTV. Drejtor i ATSH. Drejtor i Administratës Publike. Ndihmës i Presidentit. Ndihmës i Kryeministrit. Kryetar i Agjensisë Kombëtare të Energjisë. Kryetar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.	
B1 Grupi i parë i drejtorëve të drejtorive (departamenteve) në varësi të 51 700 Presidencës, Këshillit të Ministrave, Kuvendit. Drejtor Departamenti në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Kuvend. Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes. Këshilltar i Kryesisë së Kuvendit. Ndihmës i Zëvendëskryeministrit. Kryekoordinator në Departamentin e Koordinimit në Këshillin e Ministrave. Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve.	
B2 Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në Ministri, dhe në varësi të Ministrive. 49 500 Koordinator në Këshillin e Ministrave. Drejtor i Drejtorisë së Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Drejtor i Drejtorisë së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë. Shef i Kabinetit të Ministrit. Jurist në departamentin juridik në Presidencë në Këshillin e Ministrave, dhe në Kuvend. Sekretar Shkencor në Akademinë e Shkencave Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave	
B3 Grupi i Dytë i Drejtorëve të Drejtorive në varësi të Presidencës, 41 800 Këshillit të Ministrave, të Kuvendit. Drejtor Drejtorie në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Kuvend. Këshilltar i Ministrit. Këshilltar në Komisionin Parlamentar. Këshilltar në Kuvend. Këshilltar Juridik në Gjykatën e Lartë. Zëvendëskryetar i Bashkisë së Tiranës. Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i RTSH. Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë. Drejtor i Radios së Jashtme, Drejtor i Radios së Brendëshme. Drejtor i Televizionit. Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Burgjeve. Kryetar i Këshillit të Rrethit Tiranë.	
B4 Kryetar i Këshillit në Rrethet e Kategorisë së parë. 34 100 Kryetar i Bashkisë së Kategorisë së parë. Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës.	

Shef i Zyrës së Pritjes së Popullit në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Kuvend. Përgjegjës Sektori në Presidencë, në Këshillin e Ministrave në Kuvend. Drejtor i Përgjithshëm në Bashkinë e Tiranës. Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë së Tiranës. Profesor, drejtues kërkimesh, kryeinspektor i shërbimit të inspektoriatit të përgjithshëm financiar në Ministrinë e Financave. Inspektor në Drejtorinë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë. Inspektor i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes. Këshilltar i Sekretarit të Shtetit. Zëvendësdrejtor në Drejtorinë e Inspektimit dhe Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë. Zëvendësdrejtor i Grupit të parë të Drejtorive (Departamenteve) në varësi të Presidencës, të Këshillit të Ministrave, të Kuvendit. Zëvendësdrejtor i Drejtorive të Përgjithshme në varësi të ministrive. Zëvendësdrejtor i ATSH. Kryeinspektor i inspektoriatit në Ministrinë e Pushtetit Lokal . Këshilltar i Kryetarit të Komitetit të Zhvillimit të Turizmit. Drejtor Drejtorie në Ministri.	28
B5 Kryetar i Këshillit të rrethit të kategorisë së dytë. 600 Kryetar i Bashkisë së kategorisë së dytë. Asistent Profesor. Mjeshtër kërkimesh. Drejtor i Drejtorisë Teknike në RTV. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike në RTV. Zëvendësdrejtor i Televizionit, Zëvendësdrejtor i Radios së Brendshme e të Jashtme. President i Këshillit Kombëtar të Urdhërit të Mjekut. Kryetar Seksioni në Akademinë e Shkencave. Këshilltar i Kryetarit të Komisionit të Kthimit të Pronave. Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë. Inspektor në Inspektoriatin e Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave. Zëdhënës i Ministrit. Zëdhënës i Gjykatës së Lartë. Zëvendësdrejtor i Grypit të Dytë të Drejtorive në varësi të Presidencës, të Këshillit të Ministrave, të Kuvendit. Inspektor i Inspektoriatit në Ministrinë e Pushtetit Lokal C1 Sekretar i Presidentit, Sekretar i Kryeministrit. Sekretar i Kryetarit të Kuvendit. 28 600 C2 Sekretar i Zëvendëskryeministrit, sekretar i Zëvendëskryeministrit të Kuvendit. 25 300 Sekretar teknik në Kabinetin e Presidentit, e Kryeministrit, Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit. Redaktor, bibliograf, përkthyes, stenograf, asistent, inxhinier, inspektor, ekonomist, specialist, në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Kuvend. C3 Sekretar i Ministrit. Sekretar i Sekretarit të Shtetit, Sekretar i Komisionit Parlamentar Sekretar i Sekretarit të Përgjithshëm në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Kuvend.	22 000

Lidhja nr.2**KLASIFIKIMI I PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ADMINISRATËS SË LARTË SHTETËRORE,
INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE FUNKSIONARËVE NË PUSHTETIN LOKAL**

A1	132 000
A2	121 000
A3	93 500
A4	88 000
A5	82 500
A6	77 000
A7	71 500
A8	66 000
A9	60 500
A10	58 300
A11	57 200
A12	56 100
B1	51 700
B2	49 500
B3	41 800
B4	34 100
B5,C1	28 600
C2	25 300
C3	22 000

Lidhja II**PAGA SIPAS KLASAVE**

Nr. R	Klasa	Paga bazë mujore Në lekë
1.	I	6 380
2.	II	6 600
3.	III	6 900
4.	IV	7 150
5.	V	7 425
6.	VI	7 700
7.	VII	8 085
8.	VIII	8 060
9.	IX	8 965
10.	X	9 240
11.	XI	9 615
12.	XII	10 935
13.	XIII	13 045
14.	XIV	15 555

**PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E MINISTRIVE, INSTITUCIONEVE TË
TJERA QENDRORE, RTV, ATSH DHE PREFEKTURAVE**

Nr. R	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	7 260
2.	II	7 700
3.	III	7 290
4.	IV	8 560
5.	V	9 350
6.	VI	10 010
7.	VII	11 330
8.	VIII	13 440
9.	IX	14 370
10.	X	17 670

V E N D I M

Nr.201, datë 22.4.1999

PËR DISA NDRYSHIME NË PAGAT E USHTARAKËVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 27.2.1992 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve”, bëhen këto ndryshime:

“a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 6 380 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 27 000 lekë në muaj.

b) Në pikën 2, paga e ushtarakëve, nxënësve dhe studentëve ushtarakë bëhet 770 lekë në muaj.

c) Në pikën 5, paragrafi 3, paga për ushtarin rezervist bëhet deri në 550 lekë në ditë.

d) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

“- shef i Shtabit të Përgjithshëm	64 350 lekë
- zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm	50 490 lekë
- drejtor i Përgjithshëm	52 360 lekë
- shef i kabinetit të ministrit	49 280 lekë
- këshilltar i ministrit	41 470 lekë

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 27.2.1992 “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë” bëhen këto ndryshime:

“a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bëhet 6 380 lekë në muaj dhe niveli më i lartë bëhet 27 780 lekë në muaj.

b) Në pikën 3, paga e ushtarakëve të shërbimit të detyrueshëm dhe studentëve të

shkollave të Ministrisë së Rendit Publik bëhet deri në 770 lekë në muaj

c) Për ushtarakët e sistemuar të Ministrisë së Rendit Publik, paga e të cilëve është përcaktuar me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave (jashtë sistemit të pagave me klasa), pagat rriten 10 për qind.

d) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- drejtor i Përgjithshëm i policisë	61 050 lekë
- zëvendës drejtor i Përgjithshëm i policisë	55 280 lekë
- komandant i Gardës së Republikës	55 280 lekë
- drejtor i Policisë së Burgjeve	47 850 lekë

Funksionet “Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve” kalojnë në funksione civile.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 27.2.1992 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve në Shërbimin Informativ Kombëtar” bëhen këto ndryshime:

“a) Në pikën 1, niveli më i ulët bëhet 6 380 lekë në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 27 000 lekë në muaj.

b) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- kryetar i Shërbimit Informativ Kombëtar	82 500 lekë
- zëvendëskryetar i Shërbimit Informativ Kombëtar	56 100 lekë
- inspektor i Përgjithshëm në Shërbimin Informativ Kombëtar”	56 100 lekë

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga fondet e miratuara nga buxheti i shtetit për vitin 1999.

5. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 1.5.1999

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 202, datë 22.4.1999

PËR DISA NDRYSHIME NË PAGAT E PUNONJËSVE TË TATIMEVE DHE DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 437, datë 3.9.1993 “Për pagat e punonjësve të tatimeve dhe doganave”, bëhen këto ndryshime:

a. Në pikën 1, paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve,	
Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave,	
Këshilltar i plotfuqishëm, i ngarkuar për bashkërendimin	
Ndërmjet organeve të policisë tatimore dhe doganore	51 600 lekë

- b. Në pikën 2, paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:
Zëvendësdyrëtor i Doganave
Zëvendësdyrëtor i Tatimeve 36 850 lekë
- c. Në pikën 3, niveli më i ulët i pagës bëhet 7 700 lekë në muaj kurse niveli më i lartë (kryetar dege, dyrëtor dyrëtorie) bëhet 20 350 lekë në muaj.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara nga buxheti i shtetit për vitin 1999.
3. Ky vendim i shtrihet efektet e tij financiare nga data 1.5.1999.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.204, datë 22.4.1999

PËR SHPËRBLIMIN E UDHËHEQËSIT SHKENCOR TË DISERTACIONIT DHE TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT SHKENCOR

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Udhëheqësit shkencor, të disertacionit, për kohëzgjatjen e përgatitjes së disertacionit, i njihet një ngarkesë prej 90 orësh mësimore në vit, por jo më shumë se 360 orë për tërë periudhën.
 2. Udhëheqësi shkencor duhet të raportojë çdo vit për ecurinë e punës së disertantit dhe pjesët e përfunduara të disertacionit duhet të depozitohen pranë shkollës së lartë, institucioneve apo qendrave kërkimore në dosjen përkatëse të kandidatit. Në rast se disertanti nuk realizon detyrën për vitin përkatës udhëheqësi nuk e përfiton të plotë ngarkesën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi. Në këtë rast masa e ngarkesës përcaktohet nga komisioni i kualifikimit shkencor.
 3. Anëtarët e komisionit të kualifikimit shkencor përfitojnë një shpërblim në masën 50 për qind të pagës së titullit “Profesor”, ndërsa kryetari i komisionit përfiton një shpërblim në masën 75 për qind të pagës së titullit “Profesor”. Komisioni nuk përfiton shpërblim për muajt që nuk mblidhet.
 4. Anëtarët e grupeve të punës, të formuara me anëtarët e komisionit të kualifikimit shkencor, për studime dhe analiza të veçanta, të paguhen me orë efektive mësimore, sipas tarifave përkatëse.
 5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.207, datë 28.4.1999

PËR NDARJEN DHE RISTRUKTURIMIN INSTITUCIONAL TË FONDIT TË ZHVILLIMIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 544, datë 29.7.1998 “Për riorganizimin institucional të Fondit të Zhvillimit Shqiptar”, me propozimin e zëvendëskryeminsitrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nga struktura administrative e Fondit të Zhvillimit Shqiptar të shkëputen departamenti i kredisë rurale, departamenti i kredisë urbane dhe departamenti i mbështetjes veterinarë. Fondi i Zhvillimit Shqiptar do të vazhdojë si institucion i specializuar në projektet e infrastrukturës së vogël, lokale. Veprimtaria e tij do të jetë në përputhje me statusin, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Krijimin e fondacionit “Fondi i Financimit Rural”, si institucion tranzitor, për mbështetjen teknike e financiare të krijimit të sistemit të shoqërive kursim-kredi dhe unionit të tyre. Veprimtaria e tij do të jetë në përputhje me statusin, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaria, fondi i kredisë dhe asetet fikse të departamentit të kredisë rurale, të FZSHS-së të transferohen në formë granti në Fondin e Financimit Rural, sipas marrëveshjes, që do të lidhet për këtë qëllim ndërmjet Ministrisë së Financave, FZSHS-së dhe Fondit të Financimit Rural.

4. Të transferojë veprimtarinë, asetet fikse në formë granti, fondin e kredisë në formën e blerjes, sipas termave të zbatuara nga Banka Botërore (Nëse pas një periudhe 4-vjeçare do të arrihet realizimi i të gjithë treguesve të përcaktuar në marrëveshje, ky fond do të kalojë si kontribut i qeverisë shqiptare, në formën e grantit në fondacionin “Besa”) nga departamenti i kredisë urbane të FZSHS-së te fondacioni “Besa”, sipas marrëveshjes, që do të lidhet për këtë qëllim ndërmjet Ministrisë së financave, FZSHS-së dhe fondacionit “Besa”.

Forma dhe mënyra e monitorimit të treguesve përcaktohet në këtë marrëveshje.

5. Veprimtaria dhe asetet fikse të departamentit të mbështetjes veterinarë të FZSHS-së, t’i transferohen një organizate joqeveritare, me të njëjtën natyrë veprimtarie, sipas një marrëveshjeje, që do të lidhet për këtë qëllim, ndërmjet Ministrisë së financave, FZSHS-së dhe OJQ-së. Transferimi i aseteve fikse të bëhet në formë granti.

6. Transferimi faktik i veprimtarive dhe i aseteve, në të gjitha rastet e mësipërme, të bëhet vetëm pas vlerësimit të tyre nga një kontroll financiar i pavarur.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Fondi i Zhvillimit Shqiptar për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.208, datë 28.4.1999

PËR FINANCIMIN NGA BUXHETI I SHTETIT TË KUOTËS, QË PAGUAJNË NË HOTELET E USHTARAKËVE, USHTARAKËT E SISTEMIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përballimi i shpenzimeve për një natë fjetjeje në hotelet e ushtarakëve bëhet sipas një raporti të përcaktuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes me Ministrinë e Financave, për pjesën e kostos që duhet të paguhet nga vetë ushtarakët, beqarë e të transferuar, që flenë në hotelet e ushtarakëve, dhe diferencën, që do të mbulohet nga buxheti i shtetit.

2. Efektet financiarë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në masën 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 1999 për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 30.6.1978 “Për krijimin e ndërmarrjes së ushqimit social të Shtëpisë së Ushtarakëve, Tiranë, dhe funksionimin e sektorëve të ushqimit social të veshmbathjes, në rrethe” shfuqizohet.

4. Ky vendim i shtrihet efektet nga data 1.1.1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.209, datë 28.4.1999

PËR CAKTIMIN E ADMINISTRATORËVE TË PAVARUR NË SHOQËRITË HUAMARRËSE, SUBJEKTE TË KONTROLLIT

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215. datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankare, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Administrimi i shoqërive huamarrëse, subjekte të kontrollit, “Vefa Holding”, “Kamberi”, “Cenaj & Co”, “Silva”, “M. Leka”, “Gjallica”, “Beno” dhe “Global Foods”, të vazhdojë të kryhet nga administratorët e pavarur, të caktuar sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Administratorët, në përmbushjen e detyrave të tyre, ushtrojnë të gjithë kompetencat e caktuara në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 ndryshuar me ligjin nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore të dala për shoqëritë huamarrëse.

3. Në shoqëritë me më shumë se një administrator vendimet merren në mënyrë të përbashkët. Kur një administrator jep dorëheqjen apo largohet nga detyra, zëvendësimi i tyre bëhet nga Grupi Mbikëqyrës nga personat e tjerë sipas listës rezervë.

Për plotësimin e detyrave, në planin e vitit 1999, për Grupin Mbikëqyrës, shtohen 20 vetë dhe, për pagat e punës së administratorëve, një fond prej 12 milionë lekë, të cilat përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Në vartësi të nivelit të aftësimit dhe vështirësive të procesit, Grupi Mbikëqyrës, cakton pagat mujore për secilin specialist dhe administrator, brenda kufijve minimal dhe maksimal të caktuar në lidhjen bashkëlidhur vendimit.

4. Procesi i shitjes së pasurive të shoqërive huamarrëse, caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, realizohet nëpërmjet Qendrës së Ankandit, duke zbatuar kriteret e caktuara në ligjin nr. 8386, datë 30.7.1998 “Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

5. Grupi i ekspertëve ligjorë, i krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 250, datë 30.4.1998, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.36, datë 21.1.1999, të ndjekë të gjitha procedurat gjyqësore me gjykatat për vërtetimin e pronësisë dhe saktësimin e titujve, si dhe t’i japë Qendrës së Ankandeve asistencën e nevojshme ligjore për realizimin e kontratave të shitjes së pasurive.

6. Ministria e Financave në bashkëpunim me Grupin Mbikëqyrës të hartojnë udhëzime të veçanta për veprimtarinë e punës së administratorëve dhe të ekspertëve ligjorë dhe për rregulloren e funksionit të Qendrës së Ankandeve.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

NIVELI I PAGAVE BAZË MUJORE TË ADMINISTRATORËVE DHE EKSPERTËVE TË QENDRËS SË ANKANDIT

Paga bazë mujore në lekë	
1. Administrator	45 000
2. Administrator në shoqëritë huamarrëse dhe arkëtimin e detyrimeve debitore	35- 45 000
3. Specialistë pranë Qendrës së Ankandeve	30- 40 000

LISTA E ADMINISTRATORËVE NË SHOQËRITË HUAMARRËSE

1. Në shoqërinë “Vefa Holding” sh.p.k. në administrim:

Nasip Ahmetaj

Diana Golemi

Adrian Lika
 Violeta Kraja
 Arben Abazi
 2. Në shoqërinë “Gjallica” në hetim e gjykim:
 Burbuqe Duka
 Lumturi Braja
 Daniela Riska
 Yllka Sejati
 3. Në shoqërinë “Kamberi” në administrim:
 Ymer Liksala
 Donika Papa
 Mirela Musha
 4. Në shoqërinë “Cenaj & Co” në administrim:
 Mirela Cano
 Merita Çeliku
 Fatmira Koxhaj
 5. Në shoqërinë “Silva” në administrim:
 Lirika Hysi
 Vjollca Gjylameti
 Tushe Hoxha
 6. Në shoqërinë “M. Leka” në administrim:
 Sanije Tafa
 Liljana Enesi
 Fabardha Gaçi
 7. Në shoqërinë “Global Foods”
 Flamur Laze

REZERVË

1. Përparin Kadiu
2. Luan Kamberi
3. Arben Disha
4. Mimoza Sula

STRUKTURA E PUNONJËSVE QË DO TË AKTIVIZOHEN NË SHOQËRITË RENTIERË

1. Administrator	1 vetë
2. Administrator në shoqëritë huamarrëse dhe	
- për arkëtimin e detyrimeve debitore e	
- transaksioneve të pronësisë	21 vetë
3. Ekspertët ligjorë	3 vetë
4. Specialistë pranë Qendrës së Ankandit	5 vetë
5. Specialistë koordinatorë në organet e rendit	2 vetë
6. Gjithsej	32 vetë

V E N D I M

Nr.210, datë 28.4.1999

PËR LEJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PRIVATIZIMIT PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT TË KALIMIT TË PRONËSISË PËR TROJET E OBJEKTEVE TË PRIVATIZUARA NGA SHOQËRITË HUAMARRËSE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rastet kur shoqëritë huamarrëse, subjekte të kontrollit sipas ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1999 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, kanë kryer pagesa për trojet e objekteve të privatizuara nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, përpara lëshimit të autorizimit për kalim pronësie të truallit nga kjo agjenci, veprimi financiar i kryer (pagesa) të konsiderohet i mirëqenë.

2. Agjencia Kombëtare e Privatizimit t’u lëshojë autorizimet përkatëse, për kalim pronësie për trojet e këtyre objekteve, administratorëve të shoqërive huamarrëse, sipas kërkesës së tyre dhe dokumentacionit shoqërues.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.214, datë 28.4.1999

PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, TË VLERAVE MESATARE TË TREGUT TË LIRË TË BANESAVE DHE TË KOEFICIENTIT “K”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kostoja mesatare, në shkallë republike, e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i

Banesave, për vitin 1998 është 27878 (njëzeteshtatë mijë e tetëqindeshtatëdhjetëetë) lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Vlera mesatare, në shkallë rrethi, e apartamenteve tip të tregut të lirë të banesave për vitin 1998, ka qenë sipas tabelës, e cila ii bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Vlerat e koeficientit “k”, të nenit 3, të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” është sipas tabelës, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Pikat 1, 2 dhe 3 të përdoren nga Banka e Kursimeve gjatë vitit 1999, në zbatim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” dhe nga EKB-ja, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 90, dtë 25.2.1999 “Për vlerën e shitjes së apartamenteve, të financuara me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”.

5. Ngarkohet INSTAT, që, brenda datës 31.5.1999, të sigurojë të dhënat për vlerat mesatare të tregut të lirë të banesave për rrethet Tiranë, Mirditë, Sarandë, Tropojë, Delvinë, Malësi e Madhe.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

TË DHËNA PËR TREGUN E LIRË TË
APARTAMENTEVE PËR VITIN 1998

Nr.	Rrethet	Mijë lekë/m ² sip shfrytëzimi
1.	Berat	21.8
2.	Bulqizë	11.23
3.	Delvinë	
4.	Devoll	21.2
5.	Dibër	15.77
6.	Durrës	27.48
7.	Elbasan	23.63
8.	Fier	27.78
9.	Gramsh	11.07
10.	Gjirokastër	30.46
11.	Has	15.30
12.	Kavajë	21.77
13.	Kolonjë	10.37
14.	Korçë	18.74
15.	Krujë	18.38
16.	Kuçovë	18.95
17.	Kukës	15.63
18.	Kurbin	23.1
19.	Lezhë	24.51
20.	Librazhd	20.61
21.	Lushnjë	11.42
22.	Malësi e Madhe	
23.	Mallakastër	28.8

24.	Mat	12.34
25.	Mirditë	
26.	Peqin	26.84
27.	Përmet	15.13
28.	Pogradec	21.97
29.	Pukë	19.04
30.	Sarandë	
31.	Skrapar	10.71
32.	Shkodër	23.4
33.	Tepelenë	14.47
34.	Tiranë	
35.	Tropojë	
36.	Vlorë	27.47

VLEFTAT E KOEFICIENTIT “K”,
SIPAS NENIT 3 TË LIGJIT NR. 8030, DT. 15.11.1995
“PËR KONTRIBUTIN E SHTETIT PËR FAMILJET E PASTREHA”

Nr.	Rrethet	Vleftat e koeficientit “k”
1.	Berat	0.78
2.	Bulqizë	0.40
3.	Delvinë	
4.	Devoll	0.77
5.	Dibër	0.57
6.	Durrës	0.98
7.	Elbasan	0.85
8.	Fier	0.99
9.	Gramsh	0.40
10.	Gjirokastrë	1.00
11.	Has	0.55
12.	Kavajë	0.78
13.	Kolonjë	0.37
14.	Korçë	0.67
15.	Krujë	0.66
16.	Kuçovë	0.68
17.	Kukës	0.56
18.	Kurbin	0.83
19.	Lezhë	0.88
20.	Librazhd	0.74
21.	Lushnjë	0.41
22.	Malësi e Madhe	
23.	Mallakastër	1.00
24.	Mat	0.44
25.	Mirditë	

26.	Peqin	0.96
27.	Përmet	0.54
28.	Pogradec	0.79
29.	Pukë	0.69
30.	Sarandë	
31.	Skrapar	0.38
32.	Shkodër	0.84
33.	Tepelenë	0.52
34.	Tiranë	
35.	Tropojë	
36.	Vlorë	0.99

V E N D I M

Nr.217, datë 23.4.1999

PËR KRITERET E NEGOCIMIT TË INVESTITORËVE BANKARË DHE FINANCIARË, PËR PRIVATIZIMIN E BANKËS KOMBËTARE TREGTARE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 2, të ligjit nr. 8433, datë 21.12. 1998 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, Sha”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Financave të njoftojë investorët bankarë dhe financiarë, ndërkombëtarë, të interesuar për privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare, për investitorin strategjik, fitues.

2. Investorët bankarë dhe financiarë, ndërkombëtarë, të interesuar, pas komunikimit dhe negociimeve ndërmjet tyre dhe me investitorin strategjik, të bëjnë “due diligence” të Bankës Kombëtare Tregtare, dhe, së bashku, të përgatisin një propozim të përbashkët, që do të shërbejë si bazë negociimi.

3. Pas përfundimit të veprimeve, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, grupi i investorëve të fillojë negociimet me ministrin e Financave, i cili të ndihmohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare.

4. Negociimet të zhvillohen në përputhje me aneksin 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 834, datë 30.12.1998 “Për procedurat e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.220, datë 10.5.1999

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 79, DATË 11.2.1999, “PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE DHE TRAJTIMIN ME PAGË TË EFEKTIVAVE TË KËTYRE SHËRBIMEVE”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë“, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 11.2.1999, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 2, pas fjalëve “zëvendëskryeministrit”, shtohen fjalët “Kryetari i Gjykatës Kushtetuese”.

2. Në pikën 3, pas fjalëve “ministrit të Financave” shtohen fjalët “Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

3. Në pikën 6, në paragrafin e tretë pas fjalëve “Anëtarëve të Këshillit të Ministrave”, shtohen fjalët “Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.225, datë 6.5.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 182, DATË 15.4.1999 “PËR NJË SHITESË NË FONDET BUXHETORE, PËR VËNIEN NË FUNKSIONIM TË DY BURGJEVE TË REJA”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Fjalja e fundit e vendimit nr. 182, datë 15.4.1999 “Për një shtesë në fondet buxhetore, për vënien në funksionim të dy burgjeve të reja” ndryshohet si vijon:

“Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.226, datë 6.5.1999

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TIP TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË.....PËR ADMINISTRIMIN DHE SHPËRNDARJEN E NDIHMAVE PËR POPULLSINË SHQIPTARE, TË ARDHUR NGA KOSOVA

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e memorandumit tip të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të.....për administrimin dhe shpërndarjen e ndihmave për popullsinë shqiptare, të ardhur nga Kosova.

2. Procedurat e pritjes, administrimit dhe shpërndarjes, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 166, datë 11.4.1997 “Për sigurimin dhe administrimin e ndihmave humanitare dhe të emergjencës”, nuk zbatohen në rastet kur pritja, administrimi dhe shpërndarja e ndihmave do të bëhen sipas këtij memorandumit.

3. Ky memorandum mund të lidhet ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të vendeve të Bashkimit Europian etj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE.....PËR ADMINISTRIMIN DHE SHPËRNDARJEN E NDIHMAVE PËR POPULLSINË SHQIPTARE, TË ARDHUR NGA KOSOVA

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe....., më poshtë të quajtura “palë”; duke u bazuar në marrëdhëniet e mira dhe miqësore ndërmjet dy palëve; për dhënien e shpejtë dhe efikase të asistencës për popullsinë shqiptare, të ardhur nga Kosova; Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Shqipërisë mirëpret ndihmat e dhëna nga, në kuadër të asistencës për popullsinë shqiptare, të ardhur nga Kosova.

Neni 2

Personat apo organi i ngarkuar për menaxhimin e ndihmave nga qeveria e Republikës së, do të emërohen si përfaqësuesi/it i/e palës dërguese dhe do të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me përfaqësuesi/it e ngarkuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Komisioni qeveritar për përballimin e situatës emergjente, të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptare të Kosovës, në mirëkuptim me palën dërguese, duke patur parasysh nevojat dhe kërkesat për ngritjen e kampeve të reja për strehimin e popullsisë shqiptare, të ardhur nga Kosova, për asistencë në kampet ekzistuese apo për kryerjen e veprimtarive të tjera, të rëndësishme, që lidhen me krijimin e kushteve normale jetese për popullsinë shqiptare, të ardhur nga Kosova, jo vetëm kampe, do të përcaktojnë zonën ku përfaqësuesi/it do të veprojnë.

Neni 4

Përfaqësuesi/it i/e palës dërguese, me mbërritjen e ndihmave, kanë të drejtë t'i administrojë ato duke bërë një shpërndarje sipas kërkesave dhe duke menaxhuar vetë transportin deri në destinacion.

Për plotësimin e misionit të sipërpërmendur, përfaqësuesi/it dhe personeli i tij ndihmës do të gëzojnë, së bashku me mjetet e tij të lëvizjes, liri të pakufizuar lëvizjeje.

Përfaqësuesi/it i/e palës dërguese dhe personeli i tij ndihmës do të pajisen me dokumente identifikimi dalluese, që përcaktojnë misionin e tyre.

Neni 5

Përfaqësuesi/it e të dyja palëve do të bashkëpunojnë ndërmjet tyre duke dhënë informacion dhe ndihmë, në mënyrë reciproke, dhe/ose sipas kërkesave dhe nevojave të secilës prej palëve.

Bashkëpunimi ndërmjet palëve dërguese dhe asaj pritëse do të përqëndrohet në: shkëmbimin e informacionit për nevojat për ndihma në zonat e caktuara, ku është vendosur popullsia shqiptare, e ardhur nga Kosova.

dhënien e informacionit nga përfaqësuesi/it shqiptarë për numrin e të ardhurve, lëvizjet e tyre, gjendjen shëndetësore dhe nevojat e tjera specifike;

dhënien e informacionit nga përfaqësuesi/it...për sasinë e ndihmave të dhëna dhe specifikën e tyre, duke patur si qëllim informacionin e saktë për një bashkërendim sa më të mirë, për plotësimin e kërkesave dhe të nevojave në kampet e ngritura për plotësimin e kërkesave dhe të nevojave në kampet e ngritura për strehimin e popullsisë shqiptare, të ardhur nga Kosova.

përfaqësuesi/it e palës dërguese duhet të paraqesin pranë palës pritëse listën e mallrave, të makinerive e të pajisjeve që do të vijnë, 2 ditë para mbërritjes, për të bërë të mundur çlirimin e tyre nga taksat doganore, në përputhje me ligjet në fuqi.

Neni 6

Me kërkesën e tij, përfaqësuesi/it i/e palës dërguese do të pajiset nga pala pritëse me automjete për të përmbushur misionin, kur pala dërguese e ka të pamundur përdorimin e automjetit të vet.

Neni 7

Përfaqësuesi/it i/e palës dërguese do të ketë akses në pajisjet e përshtatshme të telekomunikacionit të palës pritëse për qëllimet e misionit të vet, përfshirë ato për komunikimin

me përfaqësuesit diplomatikë e konsullorë të palës dërguese.

Përfaqësuesi/it i/e palës dërguese do të gëzojë të drejtën e komunikimit të pakufizuar me radiot e veta (përfshirë radiot e lëvizshme dhe të dorës), telefonat, telegrafët, fakset apo çdo mjet tjetër komunikimi. Pala pritëse do të sigurojë, brenda 24 orësh pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit, frekuencat në të cilat radioja mund të operojë.

Neni 8

Me përfundimin e kësaj marrëveshjeje, palët do të bien dakord për mënyrën e shpërndarjes dhe të dorëzimit të makinerive, pajisjeve dhe të aksesoreve të tjerë, që kanë shërbyer për përmbushjen e veprimtarisë së këtij misioni për të ardhurit e popullsisë shqiptare nga Kosova.

Neni 9

Ky memorandum mirëkuptimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe do të ketë vlerë tremujore, me të drejtë rinovimi edhe tre muaj të tjerë, nëse nevojat për administrimin e ndihmave do të jenë ende të pranishme.

Nëqoftëse nevoja për administrim ka mbaruar, atëherë memorandumit e humbet vlerën me anë të denoncimit me shkrim, nëpërmjet rrugëve diplomatike, të njërës prej palëve kontraktuese.

Hartuar në Tiranë, më ___/___/ 1999, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip dhe....., të dyja njëlojtë të vlefshme.

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË

V E N D I M **Nr.227, datë 6.5.1999**

PËR FURNIZIMIN ME GRURË NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE SHTETËRORE

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore të furnizojë falas me 500 (pesëqind) ton grurë, nga gjendja e grurit në depot e saj në Kukës, prefekturën e Kukësit, për përballimin e nevojave emergjente, ushqimore, të të ardhurve nga Kosova.

2. Vlëra prej 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekësh e 500 tonëve grurë të përballohet nga fondet e vëna në dispozicion të Ministrisë së Pushtetit Lokal, për të ardhurit nga Kosova.

3. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtoria

e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore dhe prefektura e Kukësit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 231, datë 22.5.1999

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 205, DATË 13.4.1999 “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8849, datë 27.1.1999 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.4. 1999, aneksi 1, në përbërjen e rajonit nr. 4, Vlorë, shtohet edhe Dega e doganës, Berat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 233, datë 22.5.1999

PËR DISA MASA PËR ZBATIMIN E EMBARGOS SË NAFTËS DHE TË NËNPRODUKTEVE TË SAJ NDAJ REPUBLIKËS FEDERALE TË JUGOSLLAVISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të rezolutave nr.1160, 1199 dhe 1203, të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për krizën në Kosovë, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Rendit Publik, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave të marrin të gjitha masat për të ndaluar daljen nga pikat e kalimit kufitar, shqiptar, të naftës e të nënprodukteve të saj, për në Republikën Federale të Jugosllavisë.

2. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të organizojnë punën për ndalimin e kalimit, të qëndrimit ose të nisjes nga territori i Republikës së Shqipërisë të mjeteve të lundrimit, të fluturimit apo të transportit tokësor, të

ngarkuara me naftë e nënprodukte të saj, të cilat kanë si vendmbërritje përfundimtare Republikën Federale të Jugosllavisë.

3. Subjektet private, që importojnë naftë ose nënprodukte të saj, janë të detyruara të paraqesin në organet doganore, një javë përpara, kontratat për lëvrimin e mallit, për çdo sasi që do të importohet nga ata.

4. Subjektet private, që tregtojnë naftë ose nënprodukte të saj, me shumicë, të prodhuara në vend ose të importuara, janë të detyruara të paraqesin pranë autoriteteve përkatëse kontratat e lidhura me subjektet, që tregtojnë shitjen me pakicë të këtyre produkteve.

5. Subjektet transportuese janë të detyruara të hartojnë dokumentacionin shoqërues të mallit që transportojnë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me kontratat, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi.

6. Ndalohet depozitimi i çdo sasie karburanti pranë dhe gjatë gjithë brezit kufitar me Republikën Federale të Jugosllavisë. Shtrirja e brezit të jetë 5 km në vijë ajrore, nga vija e kufirit shtetëror, në brendësi të territorit shqiptar.

Pikat dhe depozitat e karburantit, të cilat ndodhen brenda këtij brezi të bllokohen dhe të mos lejohet hapja e pikave apo e depozitave të tjera, deri në përfundimin e embargos.

7. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, që kanë pësuar ose që pësojnë dëme nga zbatimi i embargos, të bëjnë përllogaritjet dhe t'ia paraqesin ato Këshillit të Ministrave.

8. Ngarkohen ministrinë përkatëse për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 235, datë 22.5.1999

PËR RRITJEN E PAGAVE TË GJYQTARËVE, NDIHMËSGJYQTARËVE EFEKTIVË DHE PROKURORËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 7800, datë 2.3.1994 “Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve”, ndryshuar me ligjin nr. 8082, datë 7.3.1996, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve, rriten 10 për qind, sipas tabelave, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 1.5.1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

PASQYRA NR.1

1. PAGA MUJORE E ANËTARËVE TË GJYKATËS SË LARTË

1.1. Kryetar	83 600 lekë
1.2. Anëtar	79 400 lekë

PASQYRA NR. 2

2. PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PROKURORIVE

2.1. Në Prokurorinë e Përgjithshme

1. Prokurori i Përgjithshëm	83 600 lekë
2. Prokuror i Gjykatës së Lartë	62 700 lekë
3. Prokuror (drejtor drejtorie)	50 330 lekë
4. Prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme	47 850 lekë

2.2. Në Prokurorinë e Apelit

1. Prokuror apeli	50 330 lekë
2. Zëvendësprokuror apeli	47 850 lekë
3. Prokuror	42 900 lekë

2.3. Në Prokurorinë e rrethit Tiranë

1. Prokuror rrethi	47 850 lekë
2. Zëvendës Prokuror rrethi	42 900 lekë
3. Prokuror	39 600 lekë
4. Oficer i policisë gjyqësore	34 320 lekë

2.4. Në Prokurorinë e rretheve

1. Prokuror rrethi	42 900 lekë
2. Zëvendës Prokuror rrethi	39 600 lekë
3. Prokuror	36 300 lekë
4. Oficer i policisë gjyqësore	34 100 lekë

PASQYRA NR. 3

3. PAGA MUJORE E GJYQTARËVE

3.1. Në gjykatën e Apelit Civil dhe në Gjykatën Ushtarake të Apelit

1. Kryetar	62 700 lekë
2. Zëvendëskryetar	52 580 lekë
3. Gjyqtarë	49 500 lekë

3.2. Në gjykatën e rrethit Tiranë

1. Kryetar	49 500 lekë
2. Zëvendëskryetar	43 730 lekë
3. Gjyqtarë	40 430 lekë

3.3. Në gjykatat e rretheve

1. Kryetar	43 730 lekë
2. Zëvendëskryetar	40 430 lekë
3. Gjyqtarë	37 950 lekë

3.4. Ndihmësgjyqtar efektiv pranë gjykatave të rretheve	
1. Ndihmës gjyqtarë	26 400 lekë

PASQYRA 4

4. PAGAT E INSPEKTORIATIT PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

4.1. Kryeinspektor dhe inspektor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë

1. Kryeinspektor	62 040 lekë
2. Zëvendëskryeinspektor	52 580 lekë
3. Inspektor	49 500 lekë

V E N D I M

Nr. 240, datë 28.4.1999

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË QEVERISË PËR RISTRUKTURIMIN E PAGAVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 7583, datë 13.7.1992, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e strategjisë së qeverisë shqiptare për politikën e pagave në administratën publike, sipas aneksit nr. 1, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e projektit për reformimin e strukturës së pagave, sipas aneksit nr. 2, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Administratës Publike në Këshillin e Ministrave, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Pushtetit Lokal.

Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike në Këshillin e Ministrave dhe Ministria e Financave për koordinimin e punës.

Pika 5, e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 28.3.1998, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

STRATEGJIA E QEVERISË MBI POLITIKËN E PAGAVE

Objektivat

Për të përmirësuar cilësinë e punës, mbajtjen dhe tërheqjen e stafit të arsimuar dhe të aftë profesionalisht në sektorët prioritarë të administratës publike, reformimi i politikës së pagave është një prioritet.

Në përgjithësi, në administratën publike ka nivele të ulta pagese dhe nivele, veçanërisht, të ulta në sektorë të rëndësishëm të saj. Kjo ka sjellë si pasojë çrregullimin social në sektorët e rëndësishëm të saj, siç ishte greva e mësuesve gjatë janarit 1999; mungesën e prioritetëve në të dyja drejtimet, shpërndarjen e parave dhe shkurtimin e shpenzimeve në administratën publike; përkeqësimin e cilësisë së punës në sektorët e rëndësishëm të saj; mosshpërndarjen e burimeve njerëzore sipas nevojave; nivelin e ulët të besimit nga ana e publikut dhe mungesën e mbrojtjes nga korrupsioni ose krimi i organizuar.

Sistemi aktual i pagave ka edhe mangësi të tjera që ndikojnë në punën e personelit në administratën publike, siç janë:

1. Mungesa e politikave për mbajtjen e punonjësve dhe mungesa e nxitjes për individët
 - mungesa e mundësive të karrierës dhe zhvillimit të saj
 - mungesa e promovimit të parashikuar
 - diferencë shumë e vogël në strukturën e pagave
 - mungesa e njohjes së lidhjes midis punës dhe pagës për eksperiencën në rritjen
2. Mungesa e balancës dhe kohezionit në strukturën e pagave
 - shpërndarje e madhe ndërmjet kategorive
 - mosbalancim ndërmjet pagës bazë dhe shtesave
 - mungesa e qëndrueshmërisë së shkallëve brenda një strukture dhe ndërmjet strukturave

ekzistuese.

3. Mungesa e barazisë dhe përshtatshmërisë; mungesa e monitorimit dhe korrigjimit
 - diferenca të pajustificuara në shtesat, ndërmjet sektorëve
 - përdorimi i keq i kompensimeve dhe shtesave

Disa nga këto çështje, u morën në konsideratë në një perspektivë afatshkurtër, në përputhje me burimet e disponueshme buxhetore.

Çështjet e tjera dhe ato me karakter më teknik do të merren në konsideratë në një perspektivë afatmesme, nëpërmjet një reforme të përgjithshme të strukturës së pagave, duke përfshirë zhvillimin politik, legjislationin dhe përpjekjet korresponduese për training.

Në reformë, e cila do të koordinohet nga Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe atë të Financave, do të përfshihen të gjithë elementët përbërës. Ndërsa donatorët dhe ekspertët e huaj do të kontribuojnë në mënyrë sistematike për reformën.

Propozimet për prioritet dhe vendimet politike afatshkurtëra

1. Rritja e pagave në një mesatare prej 10% për Administratën Publike duke filluar nga 1 Maji 1999. Përcaktimin do ta bëjë Këshilli i Ministrave. Fondet janë të përcaktuara në buxhetin e shtetit.

2. Një shtesë mesatare prej 17,2% për mësuesit, duke filluar nga 1 Maji 1999. Caktimi

i fondeve do të bëhet sipas propozimit, që do të miratohet. Në skemën e re të pagesës për mësuesit janë marrë në konsideratë:

- njohja e niveleve të arsimit, siç janë sot
- shpërblimi mbi eksperiencën profesionale
- njohja e background-it arsimor të mësuesve
- njohja e specializimit të mësuesve

3. Me fillimin e konfirmimit të punonjësve të shërbimit civil, do të fillojë edhe trajtimi i ri me pagat e reja. Kostot do të llogariten dhe fondet do të përcaktohen pas përfundimit të studimit - Tetor 1999.

4. Studimi i mundësisë për ristrukturimin e pagave për punonjësit e rendit - Dhjetor 1999.

Veprimet teknike afatmesme që propozohen

1. Reforma e përgjithshme e strukturës së pagave në administratën publike (Dhjetor 1999), duke përfshirë vlerësimin e punës dhe përshkrimet e reja të punëve, me qëllim për të:

- tërhequr dhe mbajtur stafin e arsimuar dhe me aftësi profesionale në sektorët prioritarë të Administratës Publike

- marrë në konsideratë mosbalancimet, diferencat e pajustificuara dhe keq përdorimin e shtesave

- vendosur drejtimit e karrierës dhe prezantimin e zhvillimit të karrierës

- rritur diferencat brenda skemës së pagave

- unifikuar shkallët midis grupeve dhe sektorëve drejt një shtrirje të mundshme

2. Projektimi dhe kalimi i statusit, përgjegjësi, pagesës dhe kushteve të tjera (Dhjetor 1999), të përcaktuar nga ligji për:

- Zyrtarët politikë, d.m.th. funksionarët e lartë shtetëror në strukturën aktuale të pagave

- Punonjësit e Shërbimit Publik, d.m.th. jo zyrtarët politik dhe jo nëpunësit civilë por, p.sh. mësuesit, mjekët dhe zyrtarët e tjerë të administratës publike

- Zyrtarët në pushtetin lokal

Burimet dhe organizimi

Grupet e punës që përfshijnë përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Rendit.

Gjithashtu, edhe ministri të tjera, sipas fushave ku do të bëhet ristrukturimi.

Koordinimi, nga Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrinë e Financave.

Rrjeti i Drejtorëve të Personelit.

Mbështetja afatmesme e PHARE, nën programin SIPAR.

Mbështetja afatmesme e Bankës Botërore.

Ky proces përfundon në dhjetor 1999.

Aneksi 2

PROJEKT PËR REFORMIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Hyrje

Qeveria shqiptare është angazhuar për rritjen e nivelit të pagave, brenda mundësive të buxhetit të shtetit, në sektorë të administratës publike, të cilët ajo i konsideron prioritarë.

Reforma e pagave është një nga prioritetet e përcaktuara në projektin SIPAR të BE dhe Kredinë e Bankës Botërore për Asistencën Strukturore.

Strategjia e paraqitur ka bërë një ndarje të problemeve afatshkurtra, që kanë më tepër karakter politik, të cilat duhet të zgjidhen, për realizimin e angazhimit të qeverisë, dhe çështje të natyrës më teknike, të cilat do të zgjidhen në një periudhë kohe afat mesme. Ky program ka për qëllim, më tepër hartimin e aktiviteteve teknike afat mesme të nevojshme për reformimin e gjithë strukturës së pagave në Shqipëri, megjithatë është marrë në konsideratë fakti, që disa rezultate duhet të arrihen për një periudhë afatshkurtër për realizimin e angazhimit politik, për rritjen e pagave për grupe të veçanta (arsimtarët, mjekët).

Nevoja për rezultate të menjëhershme afat shkurtër do të realizohet përmes një projekti pilot, në kuadrin e përgjithshëm të projektit. Gjithashtu kjo eksperiencë do të shërbejë edhe si një testim për funksionimin dhe koordinimin e grupit të punës të ngritur për këtë qëllim.

Organizimi:

- Organi vendim marrës është Këshilli i Ministrave.
- Bordi Ndërmintor, i drejtuar nga Zëvendëskryeministri, përgatiti vendimin e Këshillit të Ministrave.
- Është ngritur grupi i punës i përbërë nga përfaqësues të Departamentit të Administratës Publike, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit.
- Departamenti i Administratës Publike është përgjegjës, si për koordinimin e punës së grupit e të ekspertëve të huaj, të angazhuar për këtë qëllim, ashtu edhe për arritjen e rezultateve.
- Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale është përgjegjëse për negociimin me sindikatat.
- Grupi i punës për zhvillimin e burimeve njerëzore, që përbëhet nga drejtorët e personelit të ministrive, do të angazhohet për aktivitetet e projektit që lidhen me «job evaluation, job description».
- SIGMA do të sigurojë ekspertizën në vazhdimësi, sidomos gjatë fazës së projektit pilot.
- Phare, sipas SIPAR, do të sigurojë ekspertizën afat mesme.
- Gjithashtu, Bankës Botërore do t'i kërkohet ekspertizë në fazën afat mesme.

Probleme për t'u zgjidhur:

- i) Nuk mund të bëhen përmirësime të qëndrueshme në paga, pa patur një kontroll më efektiv në klasifikimin individual dhe shpërndarjen e shtesave mbi pagë.
- ii) Një kontroll efektiv i niveleve të pagave, mund të arrihet vetëm duke realizuar përkrahimin e vendeve të punës, klasifikimin dhe vlerësimin e tyre. Ky proces jo vetëm që do të vërë në pikëpyetje sistemin ekzistues të shkallëzimit të pagave, por gjithashtu, do të hapë rrugën për një ndryshim të përgjithshëm strukturor, për të zgjidhur problemet e njohura në strukturën aktuale të pagave.
- iii) Çdo tentativë për t'u përqëndruar në ndonjë tipar të veçantë të sistemit ekzistues, rrezikon të dështojë, për shkak të ndërthurjeve që ekzistojnë ndërmjet të metave të sistemit dhe shtrembërimeve të shumta në strukturë. Megjithatë ka mundësi të reformohet struktura për një grup të veçantë, p.sh. arsimtarët, duke filluar procesin e reformimit, i cili do të vazhdojë për të gjithë sistemin.
- iv) Një administratë që funksionon mirë, presupozon përzgjedhjen mbi bazën e meritës dhe vazhdimësisë profesionale, e mbështetur kjo në nivele të përshtatshme page. Për këtë arsye,

funksionarët politikë duhet të përjashtohen nga ky projekt i reformimit të pagave. Kjo kategori mund të jetë subjekt i një legjislacioni e procedure specifike.

Rezultatet:

Struktura e reformuar e pagave duhet të përfshijë rezultatet e mëposhtme:

i) Shumë shtesa mbi pagë do të përfshihen në pagën bazë dhe struktura do të jetë më e thjeshtë.

ii) Shkallëzimet dhe shtesat mbi pagë do të jenë më të lehta për t'u kontrolluar dhe korrigjuar.

iii) Shkallëzimet dhe nivelet ndërmjet sektorëve e grupeve të ndryshme do të jenë në pajtueshmëri.

iv) Do të fillojë aplikimi i sistemit të karrierës, dhe zhvillimi i karrierës do të bëhet një element i përgjithshëm i menaxhimit.

v) Do të njihet eksperiencia në punë brenda shkallëzimit të punës.

vi) Do të racionalizohen dhe zgjerohen diferencimet, për të siguruar nivele page më tërheqëse për punë të vështira dhe grupe a sektorë prioritarë.

vii) Klasifikimi i punës do të bazohet mbi një vlerësim sistematik të punës.

Zbatimi i projektit dhe detyrat:

Projekti do të zbatohet në pesë faza. Për përfundimin e secilës fazë, do të raportohet në Bordin Ndërmnistror dhe sipas rastit, do të përgatiten projektvendimet për t'u miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Detyra kryesore është të trajtohet reformimi i strukturave kryesore që përbëjnë administratën publike. Brenda tyre, është veçanërisht i rëndësishëm trajtimi për:

i) Mësuesit, Mjekët (shih më poshtë)

ii) Nëpunësit Civilë të konfirmuar si të tillë nga Komisioni i shërbimit civil (nga ekspertët e rinj, specialistët, administratorët, deri në nivelin më të lartë të nëpunësit civil si Drejtor Drejtorie, Sekretar i Përgjithshëm. Është e rëndësishme që të kemi një strukturë të integruar ku të përfshihen të gjitha kategoritë e punonjësve të administratës publike).

iii) Rendi publik, shpresohet që të riintegrohet, struktura që mbulon sot policinë, në strukturën e përgjithshme.

iv) Rekomandohet përjashtimi i niveleve politike si dhe punonjësve të pushtetit lokal. Në strategjinë e qeverisë këto grupe janë propozuar të rregullohen me ligje të veçanta.

Faza e projektit

1. Faza e parë: veprimi pilot

Objekti është të reformohet struktura e pagave për mësuesit, në mënyrë që të përgatitet një rritje e justifikuar page, të cilën mësuesit do ta marrin më 1 Maj 1999. Gjithashtu, objekti i kësaj faze do të jetë testimi i kapaciteteve të kontributeve, koordinimit dhe marrjen e vendimit të anëtarëve të përfshirë në projekt, si dhe procedurat e kooperimit.

Detyra është hartimi i një skeme page për mësuesit që do të:

i) sigurojë rritjen e diferencave ndërmjet kategorive të ndryshme të mësuesve.

ii) përcaktimi i niveleve të ndryshme të sistemit të arsimit, duke filluar nga kopshtet e deri në institucionet post universitare.

iii) përcaktimi i formimit të ndryshëm arsimor të mësuesve.

iv) përcaktimi që mësuesit në nivelet e larta kanë specializime të ndryshme, të cilat mund ose mund të mos jenë të rëndësishme për cilësinë e rezultateve në sistemin arsimor.

v) shpërblimi i eksperiencës profesionale.

vi) marrja e masave që sistemi i propozuar të jetë në përshtatje me reformimin e përgjithshëm të strukturës së pagave.

Detyra do të përfshijë përshkrimin e punës për nivele të ndryshme, si dhe diferencat ndërmjet shkallëve të ndryshme, rishikimi i nivelit të pagës për secilin nivel dhe propozimi i një strukture të re, që do të jetë e pajtueshme me kriteret e përcaktuara më sipër.

Zbatuesi:

Do të jetë Departamenti i Administratës Publike, grupi i punës dhe dy ekspertët e SIGMA-s të cilët do të vijnë në Tiranë për të punuar së bashku për periudhën 1-5 Mars 1999.

Gjithashtu, në se do të vijë eksperti për përshkrimin e punës (i parashikuar në projektin SIPAR), do të përfshihet edhe ai.

6 Mars. Do të jetë gati, një propozim për strukturën e re të pagave në administratën publike dhe për mësuesit në veçanti.

6-10 Mars, propozimi do të diskutohet me sindikatat për të tërhequr mendimin e tyre si dhe me ekspertët të Bankës Botërore.

20 Mars, diskutimi në Bordin Ndërmnistror i propozimit, së bashku me projektvendimin përkatës për rritjen e pagave në përgjithësi dhe atyre të mësuesve në veçanti.

Gjatë Prillit 1999 do të bëhet vlerësimi i aktivitetit pilot nga Departamenti i Administratës Publike dhe SIGMA, para fillimit të fazave të tjera të projektit.

V E N D I M

Nr. 243, datë 28.5.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 201, DATË 26.3.1998 “PËR KRITERET E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE NGA SHITJA DHE QIRAJA E TRUALLIT”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të neneve 5 e 21, të ligjit nr. 7513, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.201, datë 26.3.1998 “Për kriteret e përdorimit të të ardhurave nga shitja dhe qiraja e truallit”, në pikën 1 të shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

“5 për qind e vlerës totale të të ardhurave në lekë, të arkëtuar nga shitja e trojeve të

objekteve të privatizuara nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, kalon në favor të kësaj agjencie.

Pjesa tjetër, që mbetet nga vlera totale e të ardhurave në lekë, të arkëtuar nga shitja dhe dhënia me qira e truallit, të ndahet”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 245, datë 28.5.1999

PËR VENDOSJEN E REGJIMIT TË VIZAVE PËR SHTETASIT E REPUBLIKËS SË BULLGARISË

Në mbështetje të nenit 100, pika 4 të Kushtetutës, dhe të nenit 37, pika a, të ligjit nr. 7939, datë 25.5.1995 “Për migracionin”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Shtetasit e Republikës së Bullgarisë hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku janë të pajisur, paraprakisht, me vizën e hyrjes nga përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 258, datë 3.6.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 243, DATË 15.5.1995 "PËR SHPENZIMET PËR PRITJEN, PËRCJELLJEN DHE TRAJTIMIN QË U BËHET DELEGACIONEVE TË HUAJA"

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 8439, datë 29.12.1998 "Për buxhetin e shtetit të vitit 1999", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pasqyrat nr. 1, 2 dhe 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 15.5.1995,

ndryshohen dhe zëvendësohen me pasqyrat e reja, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Pandeli Majko

Pasqyra Nr.1

Kuota maksimale ditore e ushqimit

Në lekë

Nr.	Grupet e delegacioneve	Kuota
1.	Grupi i parë	6 500
2.	Grupi i dytë	4 800
3.	Grupi i tretë	3 400

Pasqyra Nr.2

Kuota maksimale për dreka e darka zyrtare

Nr.	Grupet e delegacioneve	Kuota
1.	Grupi i parë	4 500
2.	Grupi i dytë	3 500
3.	Grupi i tretë	2 000

Pasqyra Nr.3

Kuota maksimale e pritjeve zyrtare

Nr.	Grupet e delegacioneve	Kuota
1.	Grupi i parë	800
2.	Grupi i dytë	450
3.	Grupi i tretë	260

V E N D I M

Nr. 259, datë 3.6.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 148,
DATË 2.4.1999 "PËR PËRCAKTIMIN E FONDEVE LIMIT, QË DO TË PËRDOREN
ME PROCEDURËN E PROKURIMIT TË DREJTPËRDREJTË**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, datë 26.9.1995

“Për prokurimin Publik, me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 2.4.1999 bëhen ndryshimet si vijon:
- Fjalët "...shumën prej 200 milionë lekësh" ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët "...shumën prej 400 milionë lekësh".

- Pas fjalëve "...nga Ministria e Pushtetit Lokal..." të shtohen fjalët "...vetëm për fondet ndihmë humanitare të vëna në dispozicion nga organizma e shtete të huaja..."

- Fjalët "...deri më datën 30.4.1999" ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët "...deri më datën 31.7.1999"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 264, datë 3.6.1999

PËR MIRATIMIN E PUBLIKIMIT TË KËRKESËS PËR SHPALLJEN E SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SUPERSTRADËS VORË-MAMINAS, PJESË E SUPERSTRADËS TIRANË-DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 7848, datë 25.7.1994 «Për shpronësimin për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme», me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e publikimit të kërkesës për shpalljen e shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i superstradës Vorë-Mamínas, pjesë e superstradës Tiranë-Durrës, të ndarë:

207 588 m² tokë bujqësore

2024,9 m² objekte ndërtimi

310 m² truall.

Listat emërore të pronarëve të shpronësuar, sipërfaqet përkatëse, që shpronësohen, masa e kompensimit si dhe planvendosja e këtyre sipërfaqeve i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, këshilli i rrethit të Tiranës, bashkia e Vorës dhe komunat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RRETHI: TIRANË
 BASHKIA: VORË
 Fshati: Kodër Vorë, Muçaj, Marqinet, Marikaj

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË
 SUPERSTRADËS VORË-DURRËS

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Tokë bujqësore Nr. (1-272)

		1			2	3	4	5	6	7
							Vlera në lekë			Totale (lekë) 4+5+6
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.pi	Sipërfa. M2	Çmim L/m2	Tokë bujq.	K. Bujq.	Dr. frutor	
1	Idriz	Ali	Balla	131	330	1100	363000	0	0	363000
2	Kadri	Mustafa	Gjoka	103	225	1100	247500	9000	0	256500
3	Ismail	Xhemal	Gjoka	103	322	1100	354200	12800	0	367000
4	Xhelal	Mustafa	Gjoka	103	427	1100	469700	17080	0	486780
5	Muhamet	Mustafa	Gjoka	103	540	1100	594000	21600	0	615600
6	Haxhi	Arif	Gjoka	103	610	1100	671000	4575	0	675575
7	Begir	Arif	Gjoka	103	688	1100	756800	5160	0	761960
8	Bajram	Arif	Gjoka	103	759	1100	834900	6225	0	841125
9	Qazim	Arif	Gjoka	103	830	1100	913000	6225	0	919225
10	Sanie	Isuf	Subashi	103	1608	1100	1768800	16080	0	1784880
11	Bedrie	Isuf	Bylyku	103	1608	1100	1768800	0	0	1784880
12	Bajram	Dalip	Maloku	102	3630	1100	3993000	5550	0	3993000
13	Shaban	Vathe	Gjoka	102	555	1100	610500	5250	0	616050
14	Tushe	Hider	Gjoka	102	525	1100	577500	4650	0	582750
15	Sami	Avdyl	Gjoka	102	465	1100	511500	4100	0	516150
16	Ruzhdi	Avdyl	Gjoka	102	465	1100	511500	3700	0	516150
17	Islam	Vathe	Gjoka	102	410	1100	451000	8700	0	455100
18	Muharrem	Vathe	Gjoka	102	370	1100	407000	8700	0	410700
19	Baki	Rrahman	Gjoka	101	870	1100	957000	0	0	965700
20	Hider	Rrahmen	Gjoka	101	870	1100	957000	0	0	965700
21	Petrit	Shaban	Gjoka	101	1325	1100	1457500	0	0	1457500
22	Muhamet	Nuri	Gjoka	101	210	1100	231000	0	0	231000
23	Demir	Mersin	Gjoka	101	210	1100	231000	0	0	231000
24	Skënder	Mersin	Gjoka	101	210	1100	231000	0	0	231000
25	Kamber	Zenel	Sallaku	90	90	1100	99000	0	0	99000
26	Figiri	Kadri	Ismail	90	100	1100	110000	0	0	110000
27	Bulim	Xhemal	Muca	89	91	1100	100100	910	0	101010
28	Kalem	Xhemal	Muca	89	102	1100	112200	1020	0	113220
29	Fadil	Xhermal	Muca	89	210	1100	231000	2100	0	233100
30	Shaqir	Xhemal	Muca	89	348	1100	382800	3480	0	386280
31	Vathe	Rap	Muca	89	3620	1100	3982000	36260	0	4018260
32	Adrian	Elez	Muca	89	6721	1100	7393100	67200	0	7460300
33	Enver	Sadik	Muca	89	3789	1100	4167900	37890	0	4205790
34	Qazim	Sadik	Muca	89	4320	1100	4752000	43200	0	4795200
35	Genci	Bajram	Muca	89	2700	1100	2927000	27000	0	2997000
36	Bujar	Hamdi	Muca	89	2100	1100	2310000	21000	0	2331000
37	Pullumb	Hamdi	Muca	89	2100	1100	2310000	21000	0	2331000

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RRETHI: TIRANË

BASHKIA: VORË

Fshati: Kodër Vorë, Muçaj, Marqinet, Marikaj

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SUPERSTRADËS VORË-DURRËS

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Tokë bujqësore Nr. (1-272)

		1			2	3	4	5	6	7
							Vlera në lekë			Totale (lekë) 4+5+6
Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.pi	Sipërf. m2	Çmim L/m2	Tokë bujq.	K. Bujq.	Dr. frutor	
38	Xhemal	Hamdi	Muca	89	2100	1100	2310000	21000	0	2331000
39	Shefqet	Zenel	Muca	89	1623	1100	1785300	16230	0	1801530
40	Osman	Ismail	Muca	89	7339	1100	8072900	73390	0	8146290
41	Xhaferr	Hysen	Alvora	89	287	1100	315700	0	0	315700
42	Musa	Selim	Alvora	89	143	1100	157300	0	0	157300
43	Isuf	Xhemal	Alvora	89	143	1100	157300	0	0	157300
44	Shaqir	Hajdar	Alvora	89	95	1100	104500	0	0	104500
45	Qamil	Hajdar	Alvora	89	95	1100	104500	0	0	104500
46	Besim	Hajdar	Alvora	89	95	1100	104500	0	0	104500
47	Shefik	Elez	Shera	89	221	1100	243100	0	0	243100
48	Jonuz	Islam	Alvora	89	110	1100	121000	0	0	121000
49	Sefer	Islam	Alvora	89	110	1100	121000	0	0	121000
50	Muhamet	Ramazan	Alvora	89	110	1100	121000	0	0	121000
51	Riza	Ramazan	Alvora	89	110	1100	121000	0	0	121000
52	Asllan	Adem	Alvora	89	221	1100	243100	0	0	243100
53	Mustafa	Idriz	Smaili	38	2655	1100	2920500	0	0	2920500
54	Arben	Dalip	Haxhiu	37	1302	1100	1432200	0	0	1432200
55	Xhaferr	Hysen	Alvora	37	1228	1100	1350800	0	0	1350800
56	Rexhep	Kalem	Picari	37	1197	1100	1316700	0	0	1316700
57	Agron	Asllan	Alvora	37	570	1100	627000	0	0	627000
58	Adem	Hamit	Alvora	37	570	1100	627000	0	0	627000
59	Xhemal	Hamza	Ismaili	37	1344	1100	1478400	0	0	1478400
60	Proc.	Gjyqësor		36	670	1100	737000	0	0	737000
61	“	“		36	530	1100	583000	0	0	583000
62	“	“		36	540	1100	594000	0	0	594000
63	“	“		36	540	1100	594000	0	0	594000
64	“	“		36	540	1100	594000	0	0	594000
65	“	“		36	540	1100	594000	0	0	594000
66	“	“		36	540	1100	594000	0	0	594000
67	“	“		36	540	1100	594000	0	0	594000
68	“	“		36	540	1100	594000	0	0	594000
69	“	“		36	600	1100	660000	0	0	660000
70	“	“		36	1100	1100	1210000	0	0	1210000
71	“	“		36	887	1100	975700	0	0	975700
72	Ahmet	Ismail	Picari	30	525	1100	577500	0	0	577500

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RRETHI: TIRANË

BASHKIA: VORË

Fshati: Kodër Vorë, Muçaj, Marqinet, Marikaj

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË
SUPERSTRADËS VORË-DURRËS

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Tokë bujqësore Nr. (1-272

		1			2	3	4	5	6	7
							Vlera në lekë			Totale (lekë) 4+5+6
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.pi	Sipërf. M2	Çmim L/m2	Tokë bujq.	K. Bujq.	Dr. frutor	
73	Xhaferr	Ismail	Picari	30	525	1100	577500	21000	0	598500
74	Gëzim	Ismail	Picari	30	514	1100	565400	20560	0	585960
75	Naim	Ismail	Picari	30	530	1100	583000	21200	0	604200
76	Dalip	Ismail	Picari	30	530	1100	583000	21200	0	604200
77	Pullum	Beqir	Picari	30	576	1100	633600	23040	0	656640
78	Nadire	Qazim	Picari	30	1440	1100	1584000	57600	0	1641600
79	Sali	Haxhi	Picari	30	1291	1100	1420100	51640	0	1471740
80	Jakup	Haxhi	Picari	30	1291	1100	1420100	51640	0	1471740
81	Muharrem	Seit	Picari	30	1291	1100	2751100	100040	0	2851140
82	Hamdi	Rexhep	Krasniqi	30	2501	1100	2970000	108000	0	3078000
83	Kalem	Adem	Picari	30	2700	1100	2788500	101400	0	2889900
84	Hamdi	Adem	Picari	28	2535	1100	1027400	37360	0	1064760
85	Ramazan	Sefer	Ismaili	28	934	1100	1369500	49800	0	1419300
86	Xhemali	Hamza	Ismaili	28	1245	1100	2916100	0	0	2916100
87	Kasem	Bajram	Previzi	28	2651	1100	3124000	0	0	3124000
88	Gani	Bajram	Previzi	25	2840	1100	858000	0	0	858000
89	Sabri	Bajram	Previzi	25	780	1100	858000	0	0	858000
90	Ramazan	Ahmet	Previzi	25	780	1100	1562000	0	0	1562000
91	Sherif	Ramazan	Previzi	20	1420	1100	1595000	0	0	1595000
92	Osman	Hasan	Haka	20	1450	1100	1969000	0	0	1969000
93	Ymer	Sefer	Previzi	20	1790	1100	1210000	0	0	1210000
94	Shaban	Sefer	Previzi	20	1100	1100	1232000	0	0	1232000
95	Haxhi	Ramazan	Previzi	20	1120	1100	1265000	0	0	1265000
96	Shaban	Sefer	Previzi	20	1150	1100	1408000	0	0	1408000
97	Seit	Rexhep	Picari	20	1280	1100	401500	0	0	401500
98	Baki	Reshit	Picari	20	365	1100	401500	0	0	401500
99	Shaqir	Hamit	Picari	20	365	1100	836000	0	0	836000
100	Ermullah	Ramazan	Muzhiqi	20	760	1100	825000	0	0	825000
101	Nazmi	Bajram	Previzi	20	750	1100	1584000	0	0	1584000
102	“	“	“	20	1440	1100	451000	0	0	451000
103	“	“	“	60	410	1100	451000	0	0	451000
104	“	“	“	60	410	1100	451000	0	0	451000
105	“	“	“	60	410	1100	451000	0	0	451000
106	“	“	“	60	410	1100	451000	0	0	451000
107	Xhemal	Xh.	Ismaili	60	1612	1100	1773200	0	0	1773200

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 RRETHI: TIRANË
 BASHKIA: VORË
 Fshati: Kodër Vorë, Muçaj, Marqinet, Marikaj

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË
 SUPERSTRADËS VORË-DURRËS

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Tokë bujqësore Nr. (1-272)

		1			2	3	4	5	6	7
							Vlera në lekë			Totale (lekë) 4+5+6
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.pi	Sipërfa. m2	Çmim l/m2	Tokë bujq.	K. Bujq.	Dr. frutor	
108	Ahmet	S.	Ismaili	60	1612	1100	1773200	0	0	1773200
109	Xhevdet	Qamil	Daja		243	1100	267300	0	17500	284800
110	Agim	Qamil	Daja		291	1100	320100	0	20000	340100
111	Hysni	Kapllan	Daja		513	1100	564300	0	50000	614300
112	Sabri	Kapllan	Daja		505	1100	555500	0	50000	605500
113	Nazmi	Kapllan	Daja		540	1100	594000	0	50000	644000
114	Kasem	Kadri	Xhixha		972	1100	1069200	0	75000	1444200
115	Ramazan	Bajram	Daja		972	1100	1069200	0	75000	1444200
116	Arian	Avdi	Daja		275	1100	302500	0	20000	322500
117	Avdi	Bajram	Daja		701	1100	771100	0	65000	836100
118	Jakup	Bajram	Daja		828	1100	907500	0	75000	982500

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RRETHI: TIRANË

BASHKIA: VORË

Fshati: Kodër Vorë, Muçaj, Marqinet, Marikaj

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SUPERSTRADËS VORË-DURRËS

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Tokë bujqësore Nr. (1-272

		1			2	3	4	5	6	7
							Vlera në lekë			Totale (lekë) 4+5+6
- ë) Numri i familjeve me tokë, numri i familjeve me pak tokë, numri i familjeve pa tokë (konfirmuar nga zyrat e kadastrës).

Formularët tip të këtyre treguesve i bashkëngjiten këtij vendimi.

2. Ky informacion merret nga pushteti vendor dhe shoqërohet me një relacion të hollësishëm për dinamikën e skemës ekonomike (numri i familjeve që kanë hyrë apo kanë dalë nga skema e ndihmës ekonomike, si dhe arsyet përkatëse) dhe dërgohet në drejtoritë rajonale të ndihmës dhe të shërbimeve sociale, brenda datës 1 të çdo fundkatërmujori (dhjetor, prill, gusht).

3. Drejtoritë rajonale të ndihmës dhe të shërbimeve sociale konfirmojnë saktësinë e të dhënave, nëpërmjet institucioneve përkatëse, dhe e paraqesin informacionin pranë APNSHS-së, brenda datës 10 të çdo fundkatërmujori (dhjetor, prill, gusht).

4. APNSSHS-ja e krahason këtë informacion me të dhënat e institucioneve qendrore, si me Institutin e Statistikës, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, me Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me zyrën e regjistrimit të pasurive dhe, mbi këtë bazë llogarit shumën e bllok-ndihmës dhe shpërndarjen e saj. Kjo llogaritje, së bashku me informacionin përkatës, dërgohen në Drejtorinë e Buxhetit, në Ministrinë e Financave, brenda datës 25 të çdo fund katërmujori (dhjetor, prill, gusht).

5. Sigurimi nga pushteti vendor i informacionit të saktë për treguesit e bllok-ndihmës është domosdoshmëri për llogaritjen dhe shpërndarjen e drejtë të saj.

6. APNSHS-ja, për vitin 1999, fillon grumbullimin dhe përpunimin e informacioneve në fillim të muajit korrik.

7. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimet përkatëse.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

AKT NORMATIV

Nr. 101, datë 5.3.1999

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8449, DATË 27.01.1999 “ PËR KODIN DOGANOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave ,

V E N D O S I :

Në ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “ Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Neni 7 ndryshohet si vijon:

“ Me autoritete doganore kuptohen autoritetet e ngarkuara me zbatimin e legjislacionit doganor, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore zbatimin e të cilave i është ngarkuar këtyre autoriteteve.”

2.Në nenin 8, pika 1, shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) të gjithë personat e tjerë të njohur nga legjislacioni në fuqi.”

3. Në nenin 8, pika 2 shkronja “a” ndryshohet si vijon :

“a) në rastin e një personi fizik ose të personave të tjerë të përmendur në paragrafin 1(c), çdo person që rregullisht banon në Shqipëri.”

4. Në nenin 8, pika 15, shkronja “d” fjala “shkatërrimi” zëvendësohet me fjalën “asgjësimi”.

5. Në nenin 8, pika 19 ndryshohet si vijon:

“Deklarues” do të thotë: personi që bën deklarinimin në doganë me emrin e vet ose personi në emër të të cilit bëhet deklarimi në doganë.”

6. Në nenin 9 paragrafi IV, shfuqizohet.

7. Neni 10 ndryshohet si vijon:

“Orari i funksionimit të zyrave të Administratës Doganore përcaktohet në aktet nënligjore në

zbatim të këtij Kodi.”

8. Në nenin 11, pika 3, shkronja “a”, fjala “veprimeve” zëvendësohet me fjalën “formaliteteve”.

9. Në nenin 11, pika 3, shkronja “c” ndryshohet si vijon:

“parandalimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabandë, shkeljeve dhe trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara;”.

10. Në nenin 11, pika 3, shkronja “e” ndryshohet si vijon:

“Përgatitjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare në fushën e doganave.”

11. Në nenin 11, pika 5 fjalët “... për të verifikuar nëse cilësia, sasia dhe lloji i mallrave..., ndryshohet dhe zëvendësohet me fjalët “... për të verifikuar nëse cilësia dhe sasia e mallrave...”.

12. Në nenin 12, pika 1, fjalët “Përveç rasteve të forcave madhore, dhe me përjashtim të rregjimit...” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “Përveç rasteve të forcave madhore, plotësisht të dokumentuara, dhe me përjashtim të rregjimit...”.

13. Në nenin 12, pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Drejtori i Përgjithshëm, duke bërë përjashtim nga rregulli i shprehur në paragrafin e mësipërm, kur rrethanat kërkojnë kryerje kontrollesh të veçanta, mund të vendosë që formalitetet doganore për disa kategori mallrash të përqëndrohen në zyrën doganore kufitare ose një a disa zyra doganore të brendshme”.

14. Neni 14 ndryshohet si vijon:

“1. Drejtori i Përgjithshëm emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave. Nëndrejtorët e Përgjithshëm të Doganave emërohen nga Ministri i Financave me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

2. Personeli i Administratës doganore, me përjashtim të personelit ndihmës, punësohet nëpërmjet një konkurimi publik, sipas procedurave të përcaktuara nga “Ligji për Shërbimin Civil” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe nga aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi dhe dispozita të tjera të posaçme që rregullojnë funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Personeli ndihmës punësohet me emërim nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave”.

15. Në nenin 15, pika 2, fjalët “në përputhje me...” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “Pa rënë ndesh me...”.

16. Neni 16 ndryshohet si vijon:

“1. Personeli doganor i cili kryen kontrolle, verifikime dhe rikuperime të borxhit doganor, gjatë kryerjes së detyrave të tij ka të gjitha kompetencat e policisë gjyqësore vetëm në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor. Ata veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në këtë fushë.

2. Personeli doganor mban uniformën e shërbimit dhe sipas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave mund të pajiset me armë. Në rastet kur, për nevoja të shërbimit, është e nevojshme të veprohet pa uniformë, personeli doganor duhet të paraqesë dokumentin e identifikimit lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3. Pajisja me armë dhe përdorimi i tyre nga punonjësit e doganës bëhet në përputhje me dispozitat në fuqi për armëmbajtjen dhe me rregullat e tjera mbi statusin e autoriteteve policore.

4. Personelit doganor i ndalohet të pranojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, shpërblime në para ose në natyrë për shërbimet doganore që kryen. Atij i ndalohet të ushtrojë çfarëdo lloj veprimtarie tregtare ose këshillimore, të papajtueshme me ushtrimin e veprimtarisë doganore.

5. Personeli doganor është i detyruar të ruajë sekretin profesional për të gjitha veprimtaritë që lidhen me ushtrimin e detyrës.

6. Pa rënë ndesh me dispozitat e parashikuara nga Kodi Penal, Drejtori i Përgjithshëm, mbi bazën e dispozitave në fuqi në këtë fushë, vendos masat disiplinore që duhet të merren në rastet e shkeljeve të këtij neni, sipas dispozitave në zbatim të këtij Kodi.”

17. Në nenin 21, pika 1, ndryshohet si vijon:

“Çdo person mund t’u kërkojë autoriteteve doganore informacion për zbatimin e legjislacionit doganor. Një kërkesë e tillë mund të refuzohet kur ajo nuk lidhet me një veprim importi ose eksporti që do të kryhet realisht.”

18. Në nenin 31, pika 1 fjalët “legjislacioni doganor mund të kërkojë...” ndryshohen dhe

zëvendësohen me fjalët “autoritetet doganore mund të kërkojnë...”

19. Në nenin 37, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Asnjë shtesë nuk mund t’i bëhet çmimit realisht të paguar ose që duhet të paguhet në përcaktimin e vlerës doganore, përveç rasteve të përmendura në këtë nen”.

20. Në nenin 40, pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Duke anashkaluar nenet 34, 35 dhe 36, vlera doganore e mallrave që prishen shpejt, të cilat zakonisht dërgohen me konsenjacion me kërkesë të deklaruesit, mund të përcaktohet me procedurë të thjeshtuar”.

21. Në nenin 89, pika 1, fjalët “Në përputhje me...” zëvendësohen me fjalët “Pa rënë ndesh me ...”.

22. Në nenin 95, pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Kur kontrollohet vetëm një pjesë e mallrave të përfshira në deklaratën doganore, rezultati i kontrollit të pjesshëm merret i mirëqenë për të gjithë mallin e përfshirë në atë deklaratë. Megjithatë, deklaruesi mund të kërkojë kontroll të mëtejshëm të mallrave, nëse mendon që rezultatet e kontrollit të pjesshëm nuk janë të vlefshme për pjesën tjetër të mallit të deklaruar.”

23. Në nenin 165, pika 1, fjalët “Në përputhje me ...” zëvendësohen me fjalët “Pa rënë ndesh me ...”.

24. Në nenin 197 paragrafi I, shkronja “c” ndryshohet si vijon:

“c) të braktisen dhe të kalojnë në favor të buxhetit të shtetit sipas akteve ligjore në fuqi.”

25. Në nenin 197, pika 4 ndryshohet si vijon:

“4. Shpenzimet e asgjësimit ose të braktisjes nuk përballohen nga buxheti i shtetit.”

Në nenin 197(5) fjala “shkatërrim” zëvendësohet me “asgjësim”.

26. Në nenin 199, pika 2, shkronja “o” ndryshohet si vijon:

“o” mallrat e importuara me qëllim nxitjeje të tregtisë dhe reklamim aktiviteti;”.

27. Në nenin 211, pika 2 fjalët “Në përputhje me ...” zëvendësohen me fjalët “Pa rënë ndesh me...”

28. Në nenin 212, pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Kur parashikohet nga rregullat e adoptuara në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, autoritetet doganore mund të pranojnë lloje garancish të ndryshme nga ato të përmendura në nenin 208, kur këto sigurojnë në mënyrë të njëjtë pagesën e borxhit doganor.”

29. Në fillim të nenit 246, pika 1 shtohen fjalët “ Pa rënë ndesh me dispozitat në fuqi përsa i përket parashkrimit të një borxhi doganor dhe mosvjeljes të një borxhi të tillë...”

30. Në nenin 256, pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Pa rënë ndesh me përkufizimin mbi kontrabandën quhet kundërvajtje administrative doganore dhe dënohet si e tillë, çdo veprim ose mosveprim që bie ndesh me dispozitat e parashikuara në këtë Kod, në aktet nënligjore të tij dhe me dispozita të tjera në fuqi, me përjashtim të rasteve të fuqisë madhore.”

31. Në nenin 261, pika 1, fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

“... Ky veprim ndëshkohet me një gjobë nga 30 000 lekë deri 100 000 lekë. Në rastet e diferencave në sasi përveç gjobës bëhet edhe konfiskimi i mallrave të padeklaruara dhe të gjetura në tepricë.”.

32. Në nenin 265 shtohet një paragraf 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Në rast se diferenca e konstatuar është më e vogël ose e barabartë me 2% të sasisë së deklaruar në secilën deklaratë, pasi janë zbritur nga kjo sasi edhe humbjet natyrore dhe teknike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi në këtë fushë, nuk zbatohet asnjë sanksion.”

33. Në nenin 267, pika 2, shtohen fjalët: “Nuk zbatohet anjë sanksion kur diferenca në sasi nuk kalon 5%.”.

34. Në nenin 269, pika 2 shtohen fjalët: “Nuk zbatohet asnjë sanksion kur diferenca në sasi nuk kalon 5%”.

35. Në kapitullin VIII, kreu 4, titulli ndryshohet si vijon: “Sanksionet që zbatohen për kontrabandën”.

36. Në nenin 281, pika 1, ndryshohet si vijon:

“1. Kondrabanda e parashikuar në nenin 256, paragrafi 3 dhe e përcaktuar në nenet 276 deri 280, ndëshkohet me gjobë nga dy deri në dhjetëfishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë objekt shkeljeje, pavarësisht nga ndëshkimi i parashikuar në Kodin Penal.”.

37. Pas nenit 281, shtohet neni 281/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 281/1

Në rastet e përsëritjes së kondrabandës, sanksioni i zbatuar për çdo rast nuk mund të jetë më i ulët se ai i mëparshmi.

Kondrabanda e mbetur në tentativë dënohet si kondrabanda e konsumuar.”

38. Pas nenit 281/1 shtohet neni 281/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 281/2

Kundravajtësi përveç ndëshkimit administrativ, për kondrabandën, të parashikuara nga ky Kod i nënshtrohet edhe ndjekjes penale në përputhje me dispozitat e Kodit Penal.”

39. Neni 293, ndryshohet si vijon:

1. “Autoritetet doganore kanë të drejtë të ndalojnë personat që dyshohen se kanë kryer ose kryejnë kondrabandë. Ky ndalim mund të kthehet në arrest vetëm në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

2. Kur personi lirohet në përputhje me nenin 293, pika 2, dosja përkatëse së bashku me vendimin për zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative u dërgohen, brenda 24 orësh, autoriteteve gjyqësore kompetente.”

40. Në nenin 294, pika 2, ndryshohet si vijon:

“2. Informacioni mund të merret ose kërkohet në vendet ku kryhen veprimtari prodhuese, shërbimi dhe tregtare, si dhe kudo ku ruhen shkresa dhe dokumente të tjera në lidhje me mallrat që janë objekt i shkeljeve doganore. Për të mbledhur informacion për shkeljet doganore, punonjësit e doganës mund të përgjojnë biseda ose komunikime, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

41. Në nenin 296, në shkronjën “b”, fjalët “Këshilli i Ministrave “ ndryshohet dhe zëvendësohet me fjalët “Ministri i Financave.”.

42. Në nenin 297, bëhen këto ndryshime :

- pika 3 shfuqizohet.

- në paragrafin III, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 ndryshohen përkatësisht me pikat 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të paragrafit të II-të.

43. Neni 298, ndryshohet si vijon:

“ Ngarkohet Këshilli i Ministrave që në periudhën e ndërmjetme nga miratimi i këtij Kodi në Kuvend deri në ditën e hyrjes në fuqi, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

44. Neni 299 ndryshohet si vijon: “Ky ligj hyn në fuqi me datën 15.4.1999”.

Ky akt normativ ka fuqinë e ligjit, hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij duke filluar nga data 15.4.1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë:

Thimjo Kondi	Kryesues
Vladimir Metani	Anëtar
Agron Lamaj	“
Artan Hoxha	“
Vitore Tusha	“
Nikoleta Kita	“
Natasha Sheshi	“
Vladimir Bineri	“
Vangjel Kosta	“
Ylvi Myrtja	“
Tefta Zaka	“
Bashkim Caka	“
Metush Saraçi	“
Zamir Poda	“

në seancën gjyqësore të datës 28.7.1999, mori në shqyrtim çështjen penale Nr.157, që i përket:

TË PANDEHUR: ADRIATIK GJATA

AKUZA: Dezertim dhe shpërdorim armatimi nenet 94/2 dhe 62/2 të K.P.U.

Gjykata Ushtarake Korçë me vendimin Nr.23, datë 18.12.1998, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të pandehurin Adriatik Gjata për veprën penale të dezertimit të kuadrit ushtarak në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme sipas nenit 34/2 i K.P.U. dhe e ka dënuar me 5 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të tij për veprën penale të shpërdorimit të armatimit në të njëjtat kushte, neni 62/2 i K.P.U. duke e dënuar me 5 vjet burgim. Në bashkim të dënimit sipas nenit 55 të Kodit Penal e ka dënuar përfundimisht me 5 vjet burgim.

Mbi ankimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht të të pandehurit të deklaruar dhe gjykuar në mungesë, Gjykata Ushtarake e Apelit Tiranë me vendimin Nr.122, datë 22.3.1999, ka prishur vendimin e mësipërm dhe ka pushuar gjykimin për të dyja veprat, me arsyetimin se ato janë amnistuar sipas ligjit Nr.8202, datë 27.03.1997 “Për Amnistinë”.

Kundër vendimit të gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs nga prokurori ushtarak i apelit i cili parashtron se vendimi është i kundërligjshëm përse i përket pushimit të gjykimit për krimin e shpërdorimit të armatimit pasi ai ka vazhduar edhe pas përfundimit të efekteve të ligjit për amnistinë dhe gjykata e ka aplikuar gabim atë, ndërkohë që pranohet i drejtë në rekurs pushimi i gjykimit për krimin e dezertimit. Shkak tjetër i ngritur për prishjen e vendimit të apelit është moslegjitimimi i mbrojtësit të caktuar kryesisht për të ankimuar vendimin në apel, duke ju referuar për këtë neni 410/2 të K.P.P.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relacionin e anëtarit Vladimir Metani, prokurorin që kërkoi prishjen e vendimit dhe pasi shqyrtuan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Vendimi Nr.12, datë 22.3.1999 i gjykatës Ushtarake të Apelit Tiranë, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit e për këtë shkak duhet të priset.

Gjykimi në shkallë të parë i çështjes rezulton se është bërë pa praninë e të pandehurit, i cili është deklaruar më parë nga ajo gjykatë, si person që nuk gjendet.

Sipas neneve 141 dhe 351 të Kodit të Procedurës Penale, procedohet me gjykimin në mungesë, atëhere kur mungesa është deklaruar me vendim të gjykatës për shkak të mosgjethjes, largimit vullnetar, apo fshehjes së të pandehurit. Në të gjitha rastet e deklarimit të mungesës, autoriteti procedues detyrohet t'i caktojë të pandehurit mbrojtës kryesisht atëhere kur nuk ka mbrojtës të zgjedhur ose të pranuar prej tij. Që nga ky moment, të gjitha njoftimet e organit procedues për të pandehurin i komunikohen mbrojtësit të caktuar i cili përfaqëson të pandehurin gjatë hetimit paraprak dhe në gjykimin e shkallës së parë.

Në vështrim të nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale, njoftimi i të pandehurit të gjykuar në mungesë për shkak se nuk gjendet apo të deklaruar në mungesë respektivisht neni 141 dhe 351 i K.P.P. sipas radhës bëhet në banesën e tij, vendin e punës, vendbanimin e përkohshëm, ose në vendin ku qëndron më shpesh, duke i dorëzuar aktin personave që bashkëjetojnë me të, fqinjit ose një personi që punon me të pandehurin.

Kur njoftimi nuk mund të realizohet në këtë mënyrë, atëhere akti që do të njoftohet, që në rastin konkret është vendimi i gjykatës së shkallës së parë, depozitohet në njësinë administrative ose vendit ku banon ose punon i pandehuri. Lajmërimi i depozitimit, afishohet në portën e shtëpisë së të pandehurit ose në vendin e tij të punës. Ndërsa në rastin e të pandehurit që i fshihet ndjekjes penale ligji parashikon njoftimin e tij nëpërmjet dorëzimit të aktit që njoftohet, mbrojtësit të tij dhe kur nuk ka të tillë, nëpërmjet mbrojtësit të caktuar kryesisht.

Kryerja e të gjitha kërkesave ligjore lidhur me njoftimin e të pandehurit që procedohet e gjykohet në mungesë, presupozon se i pandehuri ka marrë njoftim për çështjen penale që ka në ngarkim apo për vendimin e gjykatës lidhur me të. Duke u konsideruar ligjërisht i njoftuar për vendimin e dhënë në mungesë, të pandehurit i fillon edhe përllogaritja afateve të ushtrimit të të drejtës së ankimit ndaj vendimit, që nga dita e njoftimit. Kalimi i këtyre afateve pa u ushtruar e drejta e ankimit, i jep vendimit formë të prerë, i cili në rastin e mungesës ankimohet vetëm në kushte të caktuar ligjore.

Sipas dispozitave të K.P.P. i pandehuri që nuk është i mitur ose me të meta fizike e psiqike që e pengojnë të bëjë vetë mbrojtjen, ka të drejtë t'i drejtohet organit procedues vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur apo të pranuar prej tij. Në nenin 407 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohen rastet dhe mjetet e ankimit. E drejta e ankimit sipas paragrafit të tretë, i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht, dhe kur ai nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre. Në harmoni me këtë vlerësohet edhe përcaktimi i nenit 50/1 të K.P.P., sipas të cilit, mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen atij personalisht. Ligji procedural penal njeh një sërë të drejtash ekskluzive për të pandehurin, si e drejta për të zgjedhur ose pranuar mbrojtës, pranimi ose jo i veprës që i atribuohet, e drejta për të dhënë shpjegime, e drejta për t'u ankuar ndaj vendimeve të gjykatës, etj.

Sa më sipër gjen shprehje edhe në nenin 410/1 të K.P.P., kur përcaktohet se kundër vendimit gjyqësor i pandehuri mund të bëjë ankim vetë, ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Ndërsa, në rastin e gjykimin në mungesë, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, kur i pandehuri nuk parashtron vetë të drejtën e ankimit, këtë të drejtë ligji ja njeh vetëm mbrojtësit të autorizuar posaçërisht për ushtrimin e saj. Autorizimi kërkohet të jetë “një akt përfaqësimi i lëshuar në format e kërkuara nga ligji”. Pra ky akt, duhet të lëshohet personalisht nga vetë i pandehuri, vullneti i të cilit vërtetohet sipas rastit nga noteri ose organi që njeh ligji, dhe në të duhet të delegohet shprehimisht e drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor. Në gjykimin e çështjes, i pandehuri Adriatik Gjata pasi është deklaruar në mungesë, është përfaqësuar me një mbrojtës të caktuar kryesisht nga organi procedues dhe jo nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij.

Aplikimi i kësaj të drejte të ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë prej mbrojtësit të caktuar kryesisht nga organi procedues, sikurse është pranuar në gjykimin e të pandehurit Adriatik Gjata, mohon të drejtën e të pandehurit për të ushtruar ose jo ankim ndaj vendimit të gjykatës,

për faktin se mbrojtësi që ka bërë ankimin, nuk është zgjedhur apo pranuar prej tij. Mbrojtja kryesisht, presupozon garantimin e një procedimi dhe gjykimi të drejtë, respektimin e të drejtave dhe lirive të të pandehurit në procesin penal, por kurrësi, disponimin tërësor mbi të drejtat që ai i njeh ligji. Vetëm në rastin kur një i pandehur është nën kujdestari, ligji parashikon që kujdestari ka të drejtë të bëjë çdo ankim që i takon të pandehurit, ndërsa në rastet e tjera, askush nuk mund të legjitimohet, pa patur pëlqimin e të pandehurit.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se në gjykimin në shkallë të parë, për shkak të garantimit të të drejtave të pandehurit në procesin penal, mbrojtësi i caktuar kryesisht merr të gjitha atributet e të pandehurit që gjykohet në mungesë dhe legjitimohet për bërjen e kërkesave dhe kundërshtimeve që lidhen me atë fazë gjykimi. Me dhënien e vendimit, mbrojtësi përfundon se qëni palë në gjykim e për pasojë, nuk gëzon më të drejtat që ligji ju njeh palëve në procesin penal. Ushtimi i ankimit në gjykatën e Apelit nga mbrojtësi i të gjykuarit Adriatik Gjata, është bërë në kapërcim të të drejtave që i njeh ligji në këtë fazë të procedimit.

Nga ana tjetër të pandehurit të deklaruar në mungesë sipas nenit 351 të K.P.P., nuk i mohohet e drejta për të ankimuar një vendim të dhënë ndaj tij, por kjo duhet të aplikohet në formën e parashikuar me këtë rast nga dispozitat procedurale. Ai ka të drejtë, mbështetur me nenin 14/2 të K.P.P., të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur vërtetohet se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dhënë dhe mbasi të jetë njohur kjo e drejtë, ai mund të bëjë ankim kundër vendimit, sipas rastit, në gjykatën e Apelit ose në Gjykatën e Lartë.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se gjykimi i çështjes nga Gjykata Ushtarake e Apelit Tiranë me ankim të mbrojtësit të caktuar kryesisht, jo vetëm është i kundërligjshëm, por mohon edhe të drejtën e të pandehurit që të ushtrojë vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të besuar prej tij, të drejtat që i njihen me ligj. Ajo, në gjykimin e çështjes, duhej të zbatonte nenin 420/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe të vendoste mospranimin e ankimit, për shkak se mbrojtësi nuk legjitimohet në bërjen e ankimit.

Shkaku i paraqitur në rekursin e prokurorit lidhur me moslegjitimitimin e bërjes së ankimit nga ana e mbrojtësit të caktuar për gjykimin në apel sikurse u pranua më lart, çmohet se është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ndërkohë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr.47 të datës 28.01.1999, kanë unifikuar praktikën gjyqësore dhe kanë njohur të drejtën e mbrojtësit të caktuar kryesisht për të ankimuar vendimet e dhëna në mungesë të të pandehurit. Ky vendim çmohet jo i drejtë, dhe praktika gjyqësore duhet të ndryshohet, jo vetëm për faktin se kështu mohohen të drejtat e të pandehurit në procesin penal, por edhe sepse njohja e kësaj të drejte mbrojtësit të caktuar, deformon dhe krijon anomali në vetë procesin penal.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 141/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 441, germa “c” të Kodit të Procedurës Penale

V E N D O S Ë N:

Prishjen e vendimit Nr.12, datë 22.13.1999 të Gjykatës Ushtarake të Apelit Tiranë dhe pushimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Unifikimin e praktikës gjyqësore sipas arsyetimit të mësipërm.

Tiranë, më 28.7.1999
Nr. 157 i Regj. Themeltar
Nr. 354 i Vendimit

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Vladimir Bineri	Kryesues
Artan Hoxha	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtar

Në seancën gjyqësore të datës 16.06.1999 mori në shqyrtim çështjen penale Nr.157 që i përket:

TË PANDEHURIT: Adriatik Gjata

A K U Z A:

Dezertim dhe shpërdorim armatimi, nenet 34/2 dhe 62/2, të Kodit Penal Ushtarak.

Gjykata Ushtarake Korçë me vendimin Nr.23, datë 18.12.1998, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Adriatik Gjata për veprën penale të dezertimit të kuadrit ushtarak në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme, neni 34/2 i K.P.U. dhe e ka dënuar me 5 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të tij për veprën penale të shpërdorimit të armatimit në të njëjtat kushte, neni 62/2 i K.P.U. duke e dënuar me 5 vjet burgim.

Në bashkim të dënimit sipas nenit 55 të K.P., e ka dënuar përfundimisht me 5 vjet burgim.

Mbi ankimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht të të pandehurit të deklaruar dhe gjykuar në mungesë, Gjykata Ushtarake e Apelit Tiranë, ka prishur vendimin e mësipërm dhe ka vendosur pushimin e gjykimit për të dyja veprat, me arsyetimin se ato janë amnistuar sipas ligjit Nr.8202, datë 27.03.1997 “Për Amnistinë”.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs nga prokurori ushtarak i apelit i cili parashtron se vendimi është i kundërligjshëm përse i përket pushimit të gjykimit për krimin e shpërdorimit të armatimit pasi ai ka vazhduar edhe pas përfundimit të efekteve të ligjit për amnistinë dhe gjykata e ka aplikuar gabim atë, ndërkohë që pranohet i drejtë në rekurs pushimin e gjykimit për krimin e dezertimit.

Shkak për prishjen e vendimit të apelit i ngritur, është moslegjitimimi i mbrojtësit të caktuar kryesisht për të ankimuar vendimin në apel, duke ju referuar për këtë nenit 410/2 të K.P.P.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e anëtarit Artan Hoxha, prokurorin Artan Bajrami që kërkoi pranimin e rekursit, në mungesë të mbrojtësit i cili nuk u paraqit pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata ushtarake e apelit ka gjykuar çështjen mbi kërkesën e mbrojtësit të caktuar kryesisht pasi i pandehuri është deklaruar dhe gjykuar në shkallë të parë në mungesë. Në këto kushte Kolegji e gjen me vend pretendimin e prokurorit lidhur me moslegjitimimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës të dhënë në mungesë, referuar nenit 410/2 të K.P.P.

Sipas dispozitave të K.P.P., i pandehuri që nuk është i mitur ose me të meta fizike e psikike që e pengojnë të bëjë vetë mbrojtjen, ka të drejtë t'i drejtohet organit procedues vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të caktuar pse të pranuar prej tij. Ndërkohë, sipas përcaktimeve të nenit 50/1 të K.P.P., mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen atij personalisht. Ligji procedural penal njeh një sërë të drejtash të tilla, si e drejta për të zgjedhur ose caktuar mbrojtës, pranimi ose jo i veprës që i atribuohet, e drejta për të dhënë shpjegime, e drejta për t'u ankuar ndaj vendimeve

të organit procedues, etj.

Sa më sipër gjen shprehje edhe në nenin 410/1 të K.P.P., kur përcaktohet se i pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Ndërkohë në rastin e gjykimit në mungesë, paragrafi i dytë i këtij neni, kur i pandehuri nuk e ushtron vetë të drejtën e ankimit, këtë të drejtë ligji ja njuh vetëm mbrojtësit të autorizuar posaçërisht për ushtrimin e saj. Në rastin e mbrojtjes së caktuar kryesisht nga organi procedues, siç është edhe në çështjen në gjykim, nuk gjen shprehje e drejta ekskluzive e të pandehurit për t'u ankuar ndaj vendimit të gjykatës, pasi mbrojtësi që ka bërë ankimin, nuk është caktuar prej tij. Mbrojtja kryesisht presupozon garantimin e një procedimi dhe gjykimi të drejtë dhe respektimin e të drejtave të të pandehurit në procesin penal, por kursesi zëvendësimin e tij në proces.

Nga ana tjetër të pandehurit të deklaruar në mungesë Kodi i P.P., nuk i mohon të drejtën për të ankimuar një vendim të dhënë ndaj tij, por kjo duhet të aplikohet në formën e parashikuar me këtë rast nga dispozitat procedurale, me kërkimin fillimisht të rivendosjes me afat, sipas përcaktimeve të nenit 147/2 të K.P.P.

Gjykimi i çështjes nga Gjykata e Apelit Ushtarak me ankim të mbrojtësit kryesisht, mohon të drejtën e të pandehurit që të ushtrojë vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të besuar prej tij të drejtat që i njuh ligji.

Ndërkohë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr.47 të datës 2.01.1999, kanë unifikuar praktikën gjyqësore duke njohur të drejtën e mbrojtësit të caktuar kryesisht për të ankimuar vendimet e dhëna në mungesë të të pandehurit. Këtë vendim e çmojmë jo të drejtë dhe praktika gjyqësore duhet të ndryshohet, jo vetëm për faktin e mohimit të të drejtave të të pandehurit në procesin penal, por njohja e kësaj të drejte mbrojtësit deformon dhe krijon anomali në vetë procedimin penal.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 9 të Ligjit Nr.8362, datë 1.7.1998, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Kasacionit dhe administrimin e shërbimeve gjyqësore",

V E N D O S I:

Kalimin për gjykim të çështjes në Kolegje të Bashkuara.

Tiranë, më 16.06.1999

V E N D I M

“NË EMËR TË POPULLIT”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Avni Shehu	Kryetar
Agim Shkupi	Anëtar
Natasha Sheshi	“
Vitore Tusha	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Plloçi	“
Agim Gjoleka	“
Metush Saraçi	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“

Zamir Poda “
Bashkim Caka “
Tefta Zaka “

Në seancën gjyqësore të datës 28.01. 1999 mori në shqyrtim çështjen penale nr. 96/1 që i përket :

I PANDEHUR: Altin Zeneli
AKUZA : Vjedhje me dhunë neni 139 K. Penal

Gjykata e rrethit Sarandë me vendimin nr. 85, datë 28.08. 1999 ka vendosur:

- Të vleftësojë si të ligjshme urdhërin e ndalimit të shtetasit Altin Zeneli.
- Të caktojë si masë sigurimi ndaj shtetasit Altin Zeneli “Arrest në burg me afat 15 ditë”.

Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. 21 datë 9.9. 1998 ka vendosur :

Lënien në fuqi të vendimit nr. 85 datë 28.8.1998 të gjykatës së rrethit Sarandë duke miratuar “Arrest në burg” me afat 15 ditë për të pandehurin Altin Zeneli.

Kundër vendimit të gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka bërë rekurs prokurori pranë kësaj gjykate duke parashtruar këto shkaqe:

Vendimi është i pabazuar në ligj, neni 244/1 i K.Pr.Penale ngarkon organin e prokurorisë për të paraqitur kërkesën lidhur me caktimin e masës së sigurimit.

Ndryshimi i bërë nga gjykata është lajthitje e nenit 280/2 të K. Pr. Penale .

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e anëtarit Vladimir Metani dhe prokuroren V. Ahmetaj e cila shprehu mendimin se është prokurori ai që përcakton nevojën e llojin e kërkesës.

V Ë R E N:

Kolegji Penal i kësaj gjykate me vendimin e tij datë 18.11.1998 ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të kësaj gjykate. Në vendimin e tij Kolegji kërkon për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore nëse: a) Gjykata cakton atë masë sigurimi që kërkohet nga organi i procedimit (prokurori).

b) Gjykata është e lirë të caktojë atë masë sigurimi që çmon se përputhet me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit të saj.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë pasi shqyrtuan çështjen në tërësi arritën në përfundimin se :

Sipas pikës 1 të nenit 244 të K.Pr.Penale organi procedues (prokurori) me kërkesën e tij vë në lëvizje gjykatën për të vendosur masat e sigurimit.

Është kjo e fundit që në përputhje me kërkesat e neneve 228 e 229 të K.Pr.Penale cakton masën e sigurimit personal. Në pikën 1 të nenit 229 të K.Pr. Penale thuhet : Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.

Të dyja gjykatat si ajo e rrethit Sarandë dhe ajo e Apelit Gjirokastrë kanë vepruar drejtë në përputhje me kërkesat e neneve të sipërcituara dhe nuk kanë asnjë “lajthitje” të nenit 260 të K.Pr.Penale siç thuhet në rekursin e prokurorit .

Ky nen ka të bëjë e do të zbatohet në rastin kur është caktuar masa e sigurimit dhe kërkohet revokimi ose zëvendësimi i saj, por dhe në këtë rast është gjykata ajo që çmon e vendos.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 441 germa “e” të K.Pr.Penale

V E N D O S Ë N:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 21 datë 09.09.1998 të gjykatës së Apelit Gjirokastrë

Tiranë, më 28.1.1999
Nr. 96/1 i Regj. Themeltar
Nr. 46 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Avni Shehu	Kryetar
Agim Shkupi	Anëtar
Natasha Sheshi	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Plloçi	“
Agim Gjoleka	“
Metush Saraçi	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Zamir Poda	“
Bashkim Caka	“
Tefta Zaka	“

Në seancën gjyqësore të datës 28.1.1999 mori në shqyrtim çështjen penale nr.134/19 që i përket:

TË PANDEHURIT: Bledar Hoxha mbrojtur nga avokat Adem Klari

AKUZA: Vrasje me dashje, në tentativë dhe armëmbajtje pa leje.

Nenet 76, 76-22, dhe 278/2 të Kodit Penal.

Gjykata e rrethit Durrës me vendimin nr.73 datë 24.4.1998 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Bledar Hoxha për krimin e vrasjes me dashje indirekte të shtetasit Ervin Maliqi, për vrasje me dashje në tentativë, armëmbajtje pa leje dhe në bazë të neneve 76, 76-22, 278/2, 55/2 dhe 51 të Kodit Penal e dënon përfundimisht me 10 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 58 datë 19.6.1998 ka vendosur :

Moapranimin e ankimit të bërë nga avokat Adem Klari.

Kundër vendimit të gjykatës së Apelit ka bërë rekurs avokati i të pandehurit Adem Klari duke parashtruar këto shkaqe:

Vendimi është i gabuar .

Si avokt i caktuar kryesisht nga gjykata unë kam marrë pjesë në dy shkallët e gjykimit .

Nuk kërkohet të kemi akt përfaqësimi sipas nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale sepse i pandehuri është i mitur dhe jam avokat i të pandehurit me një vendim gjykate.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Të angazhuara me vendimin nr. s'ka datë 9.12.1998 për unifikim të praktikës pasi dëgjuan relacionin përkatës, prokurorin Arqile Lole që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës Apelit

220

Durrës, avokatin Adem Klari që kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së Apelit dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.73 datë 24.4.1998 të gjykatës së rrethit Durrës i pandehuri Bledar Hoxha në mungesë është deklaruar fajtor dhe dënua për veprën penale të vrasjes dhe në tentativë dhe armëmbajtje pa leje.

Kundër këtij vendimi ka bërë apel avokati i të pandehurit të mitur dhe të caktuar kryesisht nga gjykata e rrethit.

Gjykata e Apelit Durrës nuk ka shqyrtuar ankimin dhe ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se avokati nuk është i pajisur me akt përfaqësimi, siç kërkon neni 410/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Kolegjet e Bashkuara të investuara nga vendimi i Kolegjit Penal nr s'ka datë 9.12.1998, mbështetur në nenin 9 të ligjit nr. 8362 datë 1.7.1998 gjejnë me vend të dalin me një vendim unifikues lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 410/2 të Kodit Pr.Penale, për të pandehurin e mitur, në mungesë, të përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht.

Ndryshe nga ç' arsyeton gjykata e Apelit Durrës në rastin në gjykim përderisa organi procedues dhe gjykata në të gjitha fazat, të pandehurit të mitur, në mungesë i kanë caktuar kryesisht me vendim, avokatin mbrojtës Adem Klari. Duke u caktuar avokati si përfaqësues i të pandehurit me vendim të gjykatës nuk është e nevojshme që ai të pajiset me akt përfaqësimi tjetër nga vetë i pandehuri apo të afërmit për të apeluar vendimin e dënimit të tij nga gjykata e shkallës së parë.

Të pandehurit të mitur dhe aq më tepër në mungesë, garancia e sipërme buron dhe nga nenet 1 dhe 6 të Kodit Pr. Penale dhe nr.17,28 dhe 31 të Kushtetutës, të cilat janë në përputhje dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e të Miturve.

Detyrimi ligjor i parashikuar nga neni 410/2 i Kodit Pr Penale që kundër vendimit të dhënë në mungesë , mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi, duhet të kuptohet për mungesën dhe largimin e vullnetshëm të pandehurit, të parashikuar nga neni 352 të Kodit Pr.Penale.

Nisur nga këto vendimi i gjykatës së Apelit Durrës për mospranimin e ankimit të avokatit të pandehurit Bledar Hoxha, duhet të priset si i pambështetur në ligj dhe çështja të dërgohet për shqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues sipas neneve 425 e vijues të Kodit të Pr. Penale.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 441/ç të K.Pr. Civile

V E N D O S Ë N:

Prishjen e vendimit nr. 58 datë 19.6.1998 të gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e akteve për shqyrtim në po atë gjykatë me trup tjetër gjykues.

Ky vendim është unifikues.

Tiranë, më 28.1.1999

Nr. 134/19 i Regj. Themeltar

Nr. 30 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Avni Shehu	Kryetar
Agim Shkupi	Anëtar
Natasha Sheshi	“
Vitore Tusha	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Plloçi	“
Agim Gjoleka	“
Metush Saraçi	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Zamir Poda	“
Bashkim Caka	“
Tefta Zaka	“

Në seancën gjyqësore të datës 28.1.1999 mori në shqyrtim çështjen penale nr. 144/2 që i përket :

TË PANDEHURIT: Astrit Kallajxhi përfaqësuar nga mbrojtësi Gëzim Haderaj.

AKUZA: Vrasje me dashje neni 83 i Kodit Penal.

Gjykata e rrethit Kuçovë me vendimin nr. 12 datë 30.4.1998 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Andriko Guveli, Astrit Kallajxhi për veprën penale të vrasjes me dashje të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal e në bazë të tij e dënon me 10 vjet burg.

Gjykata e apelit Vlorë me vendimin nr.24, datë 12.6.1998 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit në shkallë të dytë.

Kundër vendimit të gjykatës së Apelit Vlorë ka bërë rekurs mbrojtësi i të gjykuarit duke parashtruar këto shkaqe:

Mospranimi i rekursit nuk është i drejtë. Avokati i mbrojtësit i caktuar kryesisht ankimin e ka të bazuar dhe me kërkesën e të afërmeve të tij.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relacionin e anëtarit Vladimir Bineri, prokurorin Arqile Lole, i cili u shpreh se ankimi duhej pranuar nga Gjykata e Apelit Vlorë. Mbrojtësi i caktuar kryesisht gëzon të drejta të plota.

V Ë R E N:

Astrit Kallajxhi është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Kuçovë në mungesë.

Kjo gjykatë i ka caktuar kryesisht si mbrojtës avokaten Mimoza Brahimi

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Kuçovë mbrojtësja Mimoza Brahimi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.24, datë 12.6.1998 ka vendosur mospranimin e ankimit me arsyetimin se sipas nenit 420/b të Kodit të Pr.Penale mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji.

Kolegji Penal i kësaj gjykate për të unifikuar praktikën gjyqësore ia kaloi çështjen për shqyrtim Kolegjeve të Bashkuara, të cilët pasi diskutuan çështjen arritën në përfundimin se sipas nenit 64 të Kodit

222

civil caktimi ngagjykata kryesisht e mbrojtësit i jep këtij të fundit të drejtë të përfaqësoje të pandehurin sikur të ishte vetë ky i fundit.

Vendimi i marrë nga gjykata është akt i përfaqësimit të lëshuar në format e parashikuara nga ligji (neni 410/2 I Kodit Pr. Penale e 64 të Kodit Civil).

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 441/1 të K.Pr.Penale.

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit të gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim po në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Tiranë më 28.1 1999

U dorëzua për shtyp më 24.8.2000
Doli nga shtypi më 28.8.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Tipografia Ushtarake”

Çmimi: 300 lekë